

Fadil Kepi: Pensioni i parakohshëm si përfitohet nga nënat me shumë fëmijë

Ekspteri i pensioneve sqaron qytetarët në Report TV, çfarë kushtesh duhen për pensionet suplementare për ushtarakët e minatorët ▶ FAQE 12



[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI VIII - NR. 105(2320) | E DIEL, 06-05-2018 | www.shqiptarja.com

PERDHOSEN HOMAZHET

DEMOKRATET RRAHIN NOSTALGJIKET E ENVERIT

DITA E DËSHMORËVE

Simpatizantët e PD godasin komunistët në Varreza gjatë homazheve. Reagimi i Bashës: "Ndalim me ligj portreteve të Enver Hoxhës". Rama, Meta dhe Ruçi bashkë në homazhe. LSI nuk i bashkohet PD ▶ FAQE 2-3



PERGJIMET

Do korruptonin gjyqtarin e Beratit, dënohen sekseseri e qytetari



"Doli djalë me yll, por na rراسi gjobën more burrë". Dyshohet se do korruptonin me 250 mijë lekë gjyqtarin Çobanaqi

ELTON QYNO ▶ FAQE 8-9

MISTERI



Kosovari gjendet i vdekur në makinën e djegur në Fushë-Krujë

Xhafer Osmani u raportua i zhdukur në Kosovë. Familjarët na tha: "Do iki në Shqipëri"

▶ FAQE 7

MBLEDHJA E KLD

'Leksioni' i Gjin Gjonit, pse nuk duhen shkarkuar gjyqtarët

Anëtari i KLD paralajmëron rrëzimin e kërkesës për shkarkimin e 4 gjyqtarëve ▶ FAQE 6

"RILINDASI"

▶ FAQE 13-21

Simbolika e sheshit të Tiranës ndër vite, funksioni, arkitektura dhe monumentet

NGA DR. ARJOLA PRIFTI

KODIKU I KATËRT NË BIBLOTEKËN KASTRIOTASE ME PORTRETIN ORIGINAL TË SKËNDERBEUT

NGA FOTAQ ANDREA



ROLI I GAZETARIT NË DEMOKRATURË

NGA EUGJEN MERLIKA



5 MAJI / KREU I PD: LIRIA SOT E KËRCËNUAR

Lulzim Basha: Ndalim me ligj portreteve të Enver Hoxhës

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha komentoi dje incidentin mes simpatizantëve të PD dhe nostalgjikëve të Enverit. Basha tha se PD do çojë në Kuvend ligji për ndalimin e simboleve komuniste dhe shfaqjen e portreteve të gjakatarit Enver Hoxha. "Partia Demokratike është e angazhuar të çojë në Parlament ligjin për ndalimin e simboleve të komunizmit, dekomunistizimin e Shqipërisë, nderimin e plotë për heronjtë që dhanë jetën për një Shqipëri të lirë dhe demokratike por

nga ana tjetër për të bërë të qartë se kurrë më nuk do të pranojmë rikthimin e të shkuarës së përgjakshme dhe të dhimbshme për të cilën shqiptarët kanë paguar çmimin më të shtrenjtë në Evropë. Dhe kjo do të nisë me ndalimin e simboleve të komunizmit dhe portretit të gjakatarit Enver Hoxha", u shpreh Basha. Kreu i opozitës artikuloi edhe një mesazh me rastin e Ditës së Dëshmorëve. "Sot është dita kur përkulemi para sakrificës më sublime të bijve dhe bijave të Shqipërisë që u flijuan

në altarin e lirisë. Nderojmë sot ata që luftuan dhe dhanë jetën për lirinë kundër pushtuesve fashistë. Nderojmë sot ata që dhanë jetën për lirinë kundër persekutorëve komunistë. Nderojmë sot burrat dhe gratë në uniformë që dhanë jetën për lirinë e çmuar nga krimi dhe tirania e saj. Nderojmë sot Azem Hajdarin dhe heronjtë e tjerë të demokracisë që u flijuan për liri dhe demokraci", u shpreh kreu i PD. Sipas Bashës liria sot është e kërcënuar, duke iu referuar qeverisë 'Rama'.



→ BASHA

"PD është e angazhuar të çojë në Parlament ligjin për ndalimin e simboleve të komunizmit, dekomunistizimin e Shqipërisë, nderimin e plotë për heronjtë që dhanë jetën për një Shqipëri të lirë dhe demokratike".

Përleshje mes mbështetësve të PD dhe nostalgjikëve të Enverit

Gjakosen homazhet, simpatizantët e PD godasin komunistët në Ditën e Dëshmorëve pas ekspozimit të fotove të diktatorit

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Gjakosen homazhet në Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë, me rastin 5 Majit, në nderim të dëshmorëve të rënë për çlirimin e Shqipërisë. Në vend që të ishte një ditë reflektimi, bashkimi dhe nderimi për ata që dhanë jetën për Atdhe, 5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Atdheut, u kthye në një ditë përleshjes dhe akuzash. Gjatë homazheve për Ditën e Dëshmorëve pranë monumentit "Nënë Shqipëri" u konfrontuan fizikisht mbështetësit e Partisë Demokratike me nostalgjikët e diktatorit Enver Hoxha. Incidenti ndodhi në momentin kur komunistët po largoheshin nga homazhet, ndërsa në rrugë janë ndeshur me simpatizantët e PD, mes tyre anëtarë të Forumit Rinor të Partisë Demokratike (FRPD). Këta të fundit i kanë shtyrë dhe goditur komunistët, duke iu marrë nga duart edhe pankartat e simbolet e tjera komuniste. Në këtë moment nisën edhe përleshjet fizike mes mbështetësve të PD dhe nostalgjikëve. Ra në sy ish-deputeti demokrat Ndrim Babasi, i cili godet një prej nostalgjikëve të Enverit, i cili pas disa sekondash u pa i gjakosur në kokë. Pikërisht ky i fundit u shoqërua nga policia për sqarime lidhur me përplasjen. Veteranët mbanin në duar fotot e Enver Hoxhës si dhe me thirrje e brohoritma për regjimin komunist si "Rroftë Enver Hoxha" apo dhe "Poshtë

Durrës

Vangjush Dako lule mes përkrahësve të Enverit



Kryebashkiaku i Durrësit Vangjush Dako u pa të vendoste lule dje në Varrezat e Dëshmorëve të qytetit bregdetar, me rastin e 5 majit, ditës së dëshmorëve të atdheut, ndërkohë që përkrah tij u panë disa fotografi të Enver Hoxhës. Ashtu sikurse në Tiranë, edhe në Durrës disa simpatizantë të diktatorit Enver Hoxha u shfaqën me pankarta dhe foto të diktatorit. Një vajzë e mitur u pa të mbante një foto bardhezi të Hoxhës së veshur ushtarak. Një tjetër i moshuar u pa që të puthte me zell foton e diktatorit. Ndryshe nga kryeqyteti, në Durrës nuk u raportua për incidente.

fashizmi", çka ka shkaktuar irritimin e simpatizantëve të PD. Është dashur ndërhyrja e policisë për të rikthyer normalitetin dhe parandaluar përshkallëzimin e situatës. Partia Demokratike ka dënuar në vijimësi shfaqjen e portreteve të Enver Hoxhës, nga nostalgjikët të diktatorit, nëpër ceremoni të ndryshme

përkujtimore dhe nderimi për luftën kundër pushtuesve nazifashistë. PD ka paralajmëruar gjithashtu hartimin e një projektligji për ndalimin e simboleve të komunizmit, por deri më tani, demokratët hartuan vetëm një projektligj për të zhbërë 20 shkurtin, si dita e rrëzimit të bustit të Enver Hoxhës. Nisma, e publikuar

Homazhet

Komunistët pushtojnë skenën

Në pritje që Policia e Shtetit të bëjë homazhe në orë 9 dhe 30, presidenti i Republikës Ilir Meta në orën 10:00 dhe kreu i opozitës Lulzim Basha në orën 11:00, skenën rrëmbyen dje për momentin disa nostalgjikë të pakët komunistë, të cilët si çdo vit janë shfaqur me pankarta në nder të diktatorit Enver Hoxha dhe figurave të tjera kyçe të Luftës së Dytë Botërore. Në njërin prej pankartave të tyre shkruhet: "Lavdi shqiptarit të madh Enver Hoxha". Në pankartat e komunistëve, përveç Enver Hoxhës, dallohej edhe figurat e Mysym Pezës, Qemal Stafës, Hysni Kapos etj. Prania e tyre në aktivitetet të tilla ka shkaktuar shpesh polemika. Dy vitet e fundit Garda e Republikës ishte munduar që ta pengonte praninë e tyre pranë përfaqësuesve kryesorë të shtetit.



fillimisht nga Shqiptarja.com krijoji polemika dhe reagime të forta brenda së djathtës, ku për rrjedhojë Basha u detyrua që ta tërheqë menjëherë dhe të kërkonte familje në një mbledhje, ku i pranishëm ishte edhe Sali Berisha.

IRONIZON PATOZI
Ish-deputeti i PD, Astrit

Patozi ka ironizuar dje nostalgjikët e Enver Hoxhës. Në një reagim në rrjetin social Facebook, Patozi ka mbështetur ata që dhunuan disa veteranë të luftës, të cilët mbanin në duar foto të Enver Hoxhës. Patozi u ka sugjeruar nostalgjikëve që herën tjetër të mbajnë në duar foto të Edi Ramës.

Incidenti

Incidenti ndodhi në momentin kur komunistët po largoheshin nga homazhet, ndërsa në rrugë janë ndeshur me simpatizantët e PD. Këta të fundit i kanë shtyrë dhe goditur komunistët, duke iu marrë nga duart edhe pankartat e simbolet e tjera komuniste



Basha

"PD është e angazhuar të çojë në Kuvend ligjin për ndalimin e simboleve të komunizmit. Nderimin e heronjve, por nga ana tjetër kurrë më nuk do pranojmë rikthimin e të shkuarës së përgjakshme dhe të dhunshëm".



↑



Ambasadori Donald Lu homazhe për dëshmorët, përballja pikante me Metën

Ambasadori amerikan Donald Lu ka marrë pjesë paraditen e djeshme në homazhet tek Varrezat "Dëshmorët e Kombit", në nder të dëshmorëve të atdheut. Ambasadori amerikan ka vendosur një kurorë me lule pranë monumentit "Nënë Shqipëri" dhe është përshëndetur me të pranishmit. Moment pikant gjatë homazheve ka

qenë përballja me presidentin Ilir Meta në përfundim të ceremonisë. Ky moment është pritur me jo pak interes, pas deklaratës së Adriatik Llallës se ambasadori amerikan i kishte kërkuar të arrestonte ish-kryetarin e Kuvendit dhe LSI-së, por dhe siç duket nga fotot, Meta dhe Lu kanë shkëmbyer një përshëndetje të ngrohtë.

Rama, Meta dhe Ruçi bashkë në homazhe

LSI nuk i bashkohet PD-së, Luan Rama homazhe tek monumenti i Qemal Stafës, Basha tek busti i Azem Hajdarit

ADRIATIK DOÇI
TIRANË

Dita e Dëshmorëve të Atdheut ka bashkuar dje krerët e shtetit shqiptar, por jo të gjithë politikën. Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi si dhe kryetari i Bashkisë së Tiranë, Erion Veliaj, u shfaqën së bashku në homazhet për 5 Majin, Ditën e Dëshmorëve, teksa vendosën kurora me lule pranë Monumentit "Nënë Shqipëri". Gjatë ceremonisë ish-kreu i LSI, Ilir Meta, sot President i Republikës ka shtrënguar duart me kryeministrin Edi Rama dhe përfaqësues të tjerë të lartë të Partisë Socialiste. Në nderim të dëshmorëve që luftuan për liri mori pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cila vendosi kurorë me lule, si dhe zyrtarë të tjerë të lartë të shtetit. Gjithashtu, në këto homazhe morën pjesë edhe përfaqësues të trupit diplomatik. Ambasadori amerikan Donald Lu ishte mes atyre që bënë homazhe, por nuk mungoi as ambasadorja gjermane në Tiranë, Susanne Schutz. E si çdo vit, në homazhe nuk munguan as veteranët e luftës, që kujtojnë përherë shokët e tyre, si dhe familjarë të dëshmorëve, por

edhe qytetarë të thjeshtë. Ceremoni të ngjashme në përkujtim të 5 majit, Ditës së Dëshmorëve u organizuan dje në të gjithë vendin. Ndërkaq, përfaqësuesit e të djathtës shqiptare kanë zhvilluar homazhe të ndarë, në një orar tjetër dhe jo vetëm në Varrezat e Dëshmorëve.

LSI NUK I BASHKOHET PD

Lëvizja Socialiste për Integrim nuk i është bashkuar PD-së për të kujtuar 5 Majin, Ditën e Dëshmorëve. Kryetari i PD Lulzim Basha dhe deputetë të kësaj force politike kanë zhvilluar homazhe te monumenti "Nënë Shqipëri" dhe tek busti i Azem Hajdarit, ndërsa LSI ka bërë homazhe te monumenti i Qemal Stafës. Homazhet janë kryesuar nga nënkryetari i LSI, Luan Rama, ndërsa kanë marrë pjesë deputetë të kësaj force politike. "5 Maji ditë është ditë krenarie në historinë tonë kombëtare. Nderimi për dëshmorët, është nderim për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Qemal Stafa mbetet simboli i luftës së një brezi fitimtarësh. Ëndrra e dëshmorëve për Shqipërinë amanet brez pas brezi", tha Luan Rama.

MESAZHI I METËS

Presidenti i Republikës, pas homazheve në Varrezat e Dëshmorëve, u shpreh se dëshmorët e atdheut e vendosën Shqipërinë



në anën e drejtë të historisë. "Ishte kënaqësi të takoheshim edhe me përfaqësuesit e familjeve të dëshmorëve. Natyrisht ata janë kaq të shumtë, por të gjithë bashkë i bashkon përjetësia në nderim të asaj që kanë bërë për çlirimin e vendit, për 29 Nëntorin, që e vendosi Shqipërinë në anën e drejtë të historisë. Dhe jo vetëm riktheu 28 Nëntorin, që humbën më 7 prill, por njëkohësisht edhe ka bërë të mundur që Shqipëria sot të jetë edhe anëtare e NATO-s, por pse jo, edhe të ketë një perspektivë shumë të mirë edhe për çeljen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, pasi ishin ata që përcaktuan gjithashtu rrugën evropiane të Shqipërisë, ashtu sikurse edhe Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu", tha Meta.

Bashkimi

Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi si dhe kryetari i Bashkisë së Tiranë, Erion Veliaj, u shfaqën së bashku në homazhet për 5 Majin, Ditën e Dëshmorëve, teksa vendosën kurora me lule pranë Monumentit "Nënë Shqipëri".



LSI-PD

Lulzim Basha dhe deputetë të kësaj force politike kanë zhvilluar homazhe te monumenti "Nënë Shqipëri", ndërsa LSI ka bërë homazhe te monumenti i Qemal Stafës.



5 MAJI / KREU RUÇI VIZITË NË FAMILJEN E DËSHMORËS RINA STOJKU

Ruçi: Vlerat e Luftës Antifashiste janë të panegociueshme

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, me rastin 5 Majit, zhvilloi homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë. Në ceremoninë shtetërore ishin të pranishëm edhe Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, Ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, familjar të dëshmorëve, qytetar etj. Gjatë homazheve, z. Ruçi vendosi kurora me lule pranë monumentit "Nënë Shqipëri" në nderim të dëshmorëve të rënë për çlirimin e Shqipërisë. Pas ceremonisë shtetërore të homazheve, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, zhvilloi një vizitë në familjen e Simon

GRAMOZ RUÇI

"Ky vit si viti i Skënderbeut, është një arsye më shumë për të qenë të bashkuar, të përkushtuar dhe kontribuues për Shqipërinë evropiane. Kështu i vëmë një jetë idealet e dëshmorëve".

Stojku, djali i dëshmores së Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, Rina Stojku. "Jam sot në familjen tuaj të nderuar për shkak të sakrificës sublime të nënës suaj, dëshmores së atdheut Rina Stojku, por edhe te kontributit

të babait e vëllait të internuar nga pushtuesit. Këto sakrifica e jete njerëzore e rreshtuan Shqipërinë tonë të dashur në anën e duhur të historisë, në frontin antifashist dhe çlirimtar. Historia e familjes Stojku ka prodhuar edhe një simbolike tjetër të fuqishme. Babai juaj, pas kthimit nga kurbeti në vitin 1942, me paratë e fituara bleu një mal-her dhe ia dhuroi djalit, i cili doli partizan. Prandaj kam bërë dhe vazhdoj të bëj thirrje që vlerat e Luftës Antifashiste janë të panegociueshme. Lufta politike duhet të qëndrojë larg këtyre vlerave dhe të gjithë ne, të majta e të djathtë, duhet vetëm ti nderojmë ato", tha



Ruçi. Z. Simon Stojku dhe familjarët falënderuan Kryetarin e Kuvendit Z. Gramoz Ruçi, për vizitën dhe nderimin ndaj kontributit të luftëtarëve, partizanëve dhe dëshmorëve të atdheut të të gjitha kohërave dhe u shprehën se idealet e dëshmorëve mund dhe duhet të jetërsohen në kontributin për Shqipërinë demokratike, duke punuar për të mirën dhe mirëqenien e të gjithë shqiptarëve. "Ky vit si viti i Skënderbeut, është një arsye më shumë për të qenë të bashkuar, të përkushtuar dhe kontribuues për Shqipërinë evropiane. Kështu i vëmë një jetë idealet e dëshmorëve", nënvizoi Z. Ruçi.

La Repubblica:

“Po të mos ishte kthyer Rama nga Parisi, Shqipëria sot më larg BE-së!”

Në suplementin javor “Il venerdì” gazeta prestigjioze italiane i ka kushtuar një shkrim kryeministrit të Shqipërisë

Në suplementin javor “Il venerdì” gazeta italiane “La Repubblica” i ka kushtuar një shkrim kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama. Në artikull trajtohet karriera politike e Ramës, që nga koha kur ai la Parisin për t’u kthyer në Tiranë, e deri te transformimi i qytetit në kohën kur ai ishte kryebashkiak. Për Ramën si kryeministër, artikullshkruesi

Raffaele Oriani thotë se kërkon që të bëjë realitet ëndrrën e shqiptarëve, që është aderimi në Bashkimin Europian. Gazetari i La Repubblica vë në dukje problemet e shumta me të cilat përballet Shqipëria sot, por del në përfundim se po mos të ishte kthyer Rama nga Parisi, vendi sot do të ishte padyshim më larg BE-së.



Kopertina e speciales kushtuar Shqipërisë dhe Edi Ramës nga La Repubblica

● Pallatet te Brylli të lyera gjatë kohës së Ramës si kryebashkiak. Libri Kurban i kryeministrit i përkthyer në italisht dhe një selfie e tij me Matteo Renzi

shumtë ata që mendojnë se, tani që boja e fasadave ka kohë që ka dalë, se Edi Rama i ngjan gjithnjë e më shumë paraardhësit të tij. Mes të shumtëve, është edhe shkrimtari Fatos Lubonja që ka kaluar 17 vjet në burgjet komuniste të diktatorit Enver Hoxha: “E kisha si vëlla, por ajo që mendon për mua ka kohë që nuk më vret më”, thotë Rama me një zë të vendosur. Ai mbeti një intelektual, unë vendosa të mëkatoj duke u bërë politikan”. Kjo është e gjitha. Në tetor parlamenti shqiptar mohoi autorizimin e arrestimit të ish-ministrit të Brendshëm, tepër besnik i Ramës, i cili sipas Prokurorisë së Katantias është i përfshirë në një trafik droge me Italisë dhe Shqipërisë. Në përfundim të seancës kryeministri shpërtheu ndja gazetarëve që po i kërkoni llogari. Doli një spektakël i shëmtuar. Mendoni edhe ju se jeni populli? “E keni gabim” përgjigjet duke ruajtur qetësinë. “Nuk e kam zënë këtë kolltuk që të më konsumojë pushteti por që ta konsumoj atë në dobi të vendit tim”. Shqipëria është ende një vend i prapambetur, ku 40 përqind e punonjësve rropatet nëpër fusha, niveli i papunësisë e kalon 13 përqindëshin dhe përpara ambasadës gjermane ka gjithnjë radhë të diplomuarish që ikin. “Edhe sivjet ekonomia jonë do të rritet me 4 përqind” – saktësoi ai.

“Por ministrave të mi ua them gjithnjë: njerëzit nuk hanë statistika, kështu që punoni fort dhe mos u mburrni për asgjë”. Ndoshta mund t’ia kishte thënë edhe mikut të tij Matteo Renzi, por për marrëdhëniet e tij me Italinë ai paralëlqen të përdorë ironinë: “Besoj se jam miku i fundit që u ka mbetur Renzi dhe D’Alema”.

Edi Rama e nje pushtetin. Si shkrimtar paralajmëron prej “kujtudo që nuk di të bëjë gjë tjetër veçse të jetojë për të”. Kurse ai vetë si politikan e ka përdorur për të kalëruar “një kohë që nuk të jep kohë”. Bëhet fjalë për t’i bërë gjërat një nga një: “Deri më 2014-n në Shqipëri 52 përqind e energjisë elektrike humbete ose vidhej, sot jemi në 24 përqind”. Ose korrupsioni endemik i administratës publike: “Sapo ka nisur një verifikim i gjendjes pasurore të të gjithë gjyqtarëve dhe zyrtarëve të policisë. Kush nuk do të justifikojë pasuritë e tij do të shkarkohet nga puna”. Edi Rama si politikan e reciton me bindje rolin e tij, ndërsa Edi Rama si shkrimtar e di se konteksti është i vështirë dhe as vetë ai nuk ka mundur “të përbëjë një përjashtim të plotë”. Do të donim pika fikse, por gjejmë pikëpyetje. E vetmja siguri është se po të kishte qëndruar në Paris sot Shqipëria do të ishte më larg Evropës dhe se një kryebashkiak si ai do të ishte mirë edhe për shumë në qytete italiane: “Kur lexoj për gropat në Romë nuk e kuptoj problemin: përse nuk i rregullojnë?”.



● Zbarkimi i anijes Vlora me rreth 20 mijë shqiptarë në portin e Barit më 8 gusht 1991./ Fig. 3 Perëndim mbi Tiranën, kryeqytetin e Shqipërisë. Në plan të parë Parku Rinia.

NGA RAFFAELE ORIANI

SHQIPTARË, TË ZBARKOJMË NË EVROPË

Si kryebashkiak Edi Rama ringriti Tiranën. Dhe si kryeministër don që ta çojë vendin në BE. Ai është piktor dhe tani edhe shkrimtar. Por a është e vërtetë se pushteti e ka korruptuar? Shkua që ta pyesim për këtë...

Tiranë – Në Këshillin evropian të 28 qershorit udhëheqësit e Bashkimit Evropian do të duhet të vendosin nëse Shqipëria mund t’i nisë apo jo negociatat frëmëmarrëse të anëtarësimit. Kjo sepse Komisioni i Brukselit sapo ka dhënë dritën e gjelbër në sektorë kyçë si reforma në drejtësi, lufta ndaj korrupsionit dhe zhvillimi i ekonomisë së tregut. Për Shqipërinë është një lajm i mirë, por për shqiptarët nuk është i vetmi lajm i mirë: një talent i ri muzikor shqiptar, Ermal Meta, pak kohë më parë fitoi festivalin e Sanremo; një talent po aq i ri letrar, Elvis Malaj, është kandidat për çmimin “Strega”; 30 mijë sipërmarrës shqiptarë kontribuojnë me taksat e tyre në buxhetin e Italisë, dhe 20 mijë italianë kanë vendosur të jetojnë në anën tjetër të brigjeve të Adriatikut. Thuajse 30 vjet më parë dukeshin si krijesa të një tjetër bote, tani kuptohet që ishte vështrimi ynë dembel që nuk dalloj fytyrat e njëjta me tonat, por me një urie dhe dëshirë tjetër.

Sikurse ka shkruar edhe Albana Shala, drejtoreshë në Unesco, “ne shqiptarët nuk kemi qenë kurrë më të lirë, më të përgatitur, më të emancipuar se sot”. Pak popuj janë nisur nga kaq larg, pak prej tyre kanë bërë kaq shumë rrugë: grupin e bashkëkombësve e udhëheq prej shumë vitesh Edi Rama, kryeministri kolosal

që është thuajse 2 metra i gjatë dhe që ka thuajse 20 vjet në politikë. Ai ishte artist, kishte një bursë studimi në Cite’ internationale des arts të Parisit, por në fund të viteve ’90 vendosi të kthejë në atdhe dhe në vitin 2000 u bë kryetari i bashkisë së Tiranës. Në ato vite bashkia e kryeqytetit nuk kishte para, nuk kishte fuqi, nuk kishte thuajse as kuptim. Megjithatë kryebashkiaku i ri socialist vendosi që të tentonte gjithsesi. Në mënyrë që të kuptohej se era kishte ndryshuar ndërmerr një mori ngjyrosjesh mbi grinë e qytetit. “Shfrytëzua një projekt evropian për rehabilitimin urban” na thotë me një italisht të pagabueshme me të cilën ka folur gjithnjë me gjyshen me origjinë veneciane. “Kështu që fotografova fasadat e Rugës së Durrësit dhe i caktova çdo elementi arkitekturor një ngjyrë të ndryshme”. Jo më kot ishte ende i freskët nga Cite’ des arts: “Kur nisëm të lyejm me portokalli fasadën e parë, funksionari francez përgjegjës për projektin na bllokoi gjithçka duke na thënë se paratë e taksapaguesve evropianë nuk duheshin shpenzuar për karagozllëqe të tilla”. Funksionari turfullonte, punëtorët i ulën furçat, trafiku u bllokua dhe ja tek mbërrin kryebashkiaku: “Replikova duke i thënë se kjo ishte censurë, dhe se si ish-komunistë ne shqiptarët e njihim mirë”. Burokрати këmbëngulte se ajo portokalli aq e ndezur nuk hynte në standardet evropiane. Me përgjigjen e tij, kryebashkiaku nisi gjëmimin që do të kalojë të Këshilli evropian më 28 qershor: “Shihni përreth, a shihni ndonjë gjë të vetme që përkon me cilindo standard evropian?”. Dhe kështu shtëpitë nisën të ndizeshin me ngjyra, ngjyrat tërhoqën kuriozët,

shitësit patën rritje të punës, bashkia grumbulloi më shumë taksa, kryebashkiaku fitoi popullaritet, popullariteti u shndërrua në pushtet dhe me pushtet u shkatërruan qindra kioska të paligjshme, u rishtruan dhjetëra rrugë dhe madje u rikthyete edhe ngrohja në disa shkolla: “që nga rënia e komunizmit ishim mësuar t’i bënim ballë acarit dimëror me mbipopullimin e klasave”. Ai akt trasgresioni kromatik shkaktoi një varg shndërrimesh që vijojnë ende: pas viteve të egra të diktaturës komuniste dhe viteve të marra të anarkisë kapitaliste, kryeqyteti shqiptar sot duket se shijon një gëzim jetese të saj in thuajse borgjez.

Aventurës si kryebashkiak i Tiranës, kryeministri aktual, në detyrë që prej 2013-s, i ka kushtuar Kurbanin, një libër i furishëm, i dhunshëm, i papërmbajtshëm, i shkruar me pasion për punën dhe me brenjë për ata që përpiqen të ngrënë pengesa. Medalja e tij është që besoi te ky qytet kur “askush nuk e mendonte se një ditë do të mund të kishte parë një Tiranë ndryshe”; gogoli i tij është konservatori Sali Berisha, zotëuesi i Shqipërisë përpara se të hynte rama në lojë. Është një libër i jashtëzakonshëm dhe i padurueshëm, me skenare thuajse shekspiriane dhe thumbime tejet feminare. Edi Rama e thotë, dhe thuajse ulëret, se pushteti nuk e ka ndryshuar, edhe pse “nuk është e mundur të mos gabosh asnjëherë kur përballesh me ndryshimin i shoqëruar gjithnjë nga e panjohura”.

E takuam në zyrën e tij si kryeministër ku përziheshin dokumenta, lapostila, topa basketbolli, forma

abstrakte dhe ngjyra të ndezura. Në një paragraf të librit të tij autori kthehet në kundërshtarin e tij, dhe si Sali Berisha që sapo ka shtypur me gjak një protestë në shesh thotë: “Unë jam ai që ju vras në mes të bulevardit dhe ju them: eja sërisht nëse doni, jam unë populli”. Janë të

54 për qind e demokratëve kundër koalicionit me LSI-në

Vetëm 39% e mbështesin aleancën me PD, një në pesë delegatë të lidhur me partinë për shkak të punës në shtet

Më 29 prill 2018 ekipi kërkimor i Institutit të Studiimeve Politike (ISP) zhvilloi testim të një numri të madh delegatësh të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. E njëjta praktikë është ndjekur më 2016 edhe në Kongresin e PS dhe më pas edhe në Konventën Kombëtare të LSI. Pyetjet për delegatët e PD ishin: Sa trafikohen votat në zgjedhje parlamentare dhe më pas edhe në partitë politike? A ka të inkriminuar dhe të korruptuar në partitë politike dhe a duhet të përjashtohen ata? A do të ketë Veting në politikë? Cili është identiteti dhe lidhja me të djathtën? Cila do të jetë e ardhmja e koalicionit politik PD-LSI? A mund të ketë politikë kur në një pesë delegatë politikë është me status papunësie dhe mbi 40% janë familjarisht mbështetës të vendosur të një force politike? Cilat janë pikëpamjet e delegatëve të Kuvendit të Partisë Demokratike mbi sistemin zgjedhor dhe problematikat kryesore politike në vend? Rezultati i sondazhit të ISP me delegatët e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike nxori në pah se 54% janë kundër koalicionit me LSI, ndërsa 37% e mbështesin atë. Anketimi nxori në pah problematika të rëndësishme ku ndodhen partitë politike, politika dhe demokracia e brendshme brenda tyre. Shumica e të dhënave lidhen me PD, por një pjesë e tyre janë reflektim edhe i gjendjes jashtë saj, në spektrin e gjerë politik. Të dhëna të tilla si vullneti i qartë i delegatëve për të larguar nga partia personat e inkriminuar dhe të korruptuar, mbështetja masive për Veting në politikë, bindja se reformimi tërësor i sistemit përfaqësues dhe politik është zgjidhja më e mirë për të ardhmen, apo mbështetje e fortë për depolitizimin e administratës zgjedhore, janë risi pozitive dhe tregojnë nivel të lartë ndërgjegjësi politik të delegatëve, në disa raste edhe në kontrast me leadershipin politik të vetë forcës politike.

LIDHJA ME PARTINË

Delegatët e një Kuvendi Kombëtar supozohet se janë


Koalicioni me LSI

Rezultati i sondazhit të ISP me delegatët e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike nxori në pah se 54% janë kundër koalicionit me LSI, ndërsa 37% e mbështesin atë.



Pa profesion

Një pjesë e madhe e politikanëve tanë sidomos në nivel lokal, nuk kanë profesion tjetër veç marrjes me politikë, duke e parë politikën si mbijetesë, status social, burim financiar dhe jo si profesione të ideve.



qytetarë të përzgjedhur, që kanë një përgjegjësi në parti, në publik dhe në politikë. Fakti se mbi 40% e tyre lidhen me forcën politike për shkak të

traditës familjare ose se pjesa dominuese në parti i përket kategorisë së vjetër historike, tregon nevojën e madhe që kanë partitë për t'u reformuar,

hapur, krijuar hapësira të reja dhe nxitur anëtarët e saj të kenë identitet politik, të kenë formim politik dhe të kenë vizion personal për politikën dhe të ardhmen e vendit. Gjithashtu, fakti se një në pesë delegatë deklaroi se është pa marrëdhënie pune në shtet apo në privat, është tregues i natyrës së ashpër të zhvillimeve politike në vend, ku partitë fituese largojnë nga puna mbështetësit e palës tjetër, një cikël i mbyllur që përsëritet pas çdo rotacioni politik.

PA PROFESION

Nga ana tjetër kjo tregon se një pjesë e madhe e politikanëve tanë sidomos në nivel lokal, nuk kanë profesion tjetër veç marrjes me politikë, duke e parë politikën si mbijetesë, status social, burim financiar dhe jo si profesione të ideve, part time dhe aktivitet vullnetar. Të dhënat e nxjerra janë një listë këshillash mjaft të vlefshme për politikanët në PD dhe të tjerët në partitë politike, sesi duhet të merren vendime për më shumë demokraci dhe më shumë përfaqësim. Mbështetja masive për ndryshimin e sistemit zgjedhor, për zgjedhjen e Presidentit nga populli, për krijimin e senatit, për votën e emigrantëve, për depolitizimin e administratës zgjedhore, etj, janë tregues maturie dhe proteste të bazës partiake ndaj vendimarrësve politikë. Këto sugjerime kanë vlerë sidomos në stadin ku ndodhet komisioni bipartiak parlamentar, i cili duhet të bëjë ndryshime në kuadër të reformës zgjedhore. Studimi i plotë me të dhënat krahasuese për secilën nga rastet e cituara më lart, përfshirë analizën e detajuar mbi pyetësorin e zhvilluar në Kuvendin e PD 2018, do të publikohet në muajin e ardhshëm nga stafi kërkimor i Institutit të Studiimeve Politike. /ISP

Deklarata

Enkelejd Alibeaj: Ja pse Rama e mbrojti Tahirin

Partia Demokratike vijon ta shikojë si komplot dorëheqjen e Saimir Tahirit nga Parlamentit. Deputeti i PD Enkelejd Alibeaj tha dje në një konferencë për shtyp se kryeministri Rama e mbrojti 6 muaj Tahirin, për të fituar kohë. "Dy ditë pasi Tahiri, me marrëveshje me Ramën hoqi dorë nga mandati i deputetit ai vazhdon të jetë i lirë. E në fakt ka 6 muaj që ethet e kanë zënë. Ka 6 muaj që, tamam në një marrëdhënie mes mafiozësh, kur ai lëshon ST dhe ST kërcënon ER se do ta tërheqë zvarrë atë në ferr nëse e lëshon, bërin gjithçka për të shpëtuar lëkurën e vet. Nuk ia dorëzoi drejtësisë, 6 muaj më parë, duke iu bërë barrkadë me imunitetin. Në këto 6 muaj, Edi Rama shkatërroi reformën e drejtësisë, duke e rrëmbyer si një kriminel i vërtetë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe duke e vendosur nën këmbë Drejtësinë", tha Alibeaj.



'Deti'

Bushati: Raund të ri negociatash në Athinë

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, ka komentuar nga Shkodra marrëveshjen e Detit me Shqipërisë dhe Greqinë. Pas homazheve në nderim të Ditës së Dëshmorëve, Bushati i është përgjigjur interesit të medias lidhur me bisedimet me dy vendeve. Ministri Bushati homazhe te varri i dëshmorit Adrian Kodra. Ai deklaroi se raundi i fundit ishte konstruktiv, ndërkohë që bëri me dije se do të ketë një raund të ri bisedimesh, këtë herë në Athinë. "Ne jemi duke vazhduar punën dhe ky është një proces jo i lehtë. Për një pjesë të çështjeve ka dakordësi. Jemi në rrugën e duhur. Janë çështjet e kufizimeve detar. Raundi në Tiranë ishte konstruktiv. Janë bërë disa konsulta në nivel diplomatik dhe teknik. Do të ketë një raund të ri në Athinë dhe një takim me homologun grek", pohoi ai. Kryediplomati sqaro se pakti i ri detar nuk do të jetë një marrëveshje ku palët do të jenë të njëjta, por do të jetë një marrëveshje e drejtë dhe e zbatueshme.

SHPLLJE ANKANDI III



Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me permbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurine "Truall", me sipërfaqe 480 m2, nga kjo godine tre kate me sip. 129,70 m2, e rregjistruar ne ZVRPP Kavaje, Zona Kadastrale: 3101, Numri i Pasurisë: 20/207, Vol. 20 Faqe 143 e ndodhur ne Qerret, Kavaje, ne pronesi te Mentor Halim Ismaili.

Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 8,800,000 (tete milion e teteqind mije) lek ose 68,000 (gjashtedhjetë e tete mije) euro.

Ankandi i pare zhvillohet me datë 11.05.2018, ora 16:00 në ambientet e Zyrës se permbaruese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr:"Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883.

SHPLLJE ANKANDI III



Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me permbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e trete për pasurine "Apartament", me sipërfaqe 47 m2 e rregjistruar ne ZVRPP Elbasan, Zona Kadastrale: 8521, Numri i Pasurisë: 8/218+2-13, Vol. 2, Faqe 50 e ndodhur ne Lagjia "Beqir Dardha", Elbasan, ne pronesi te Sami Maksut Rroçi.

Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 1,310,400 (nje milion e treqind e dhjete mije e katerqind) LEK ose 9,828 (nente mije e teteqind e njezet e tete) EURO.

Ankandi i trete zhvillohet me datë 01.06.2018, ora 16:00 në ambientet e Zyrës se permbaruese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr:"Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883.

'Leksioni' i Gjini Gjoni, pse s'duhet shkarkuar gjyqtarët

Anëtari i KLD paralajmëron rrëzimin e kërkesës së ministres së Drejtësisë për shkarkimin e 4 gjyqtarëve, nesër mbledhja


ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Ministria i Drejtësisë i ka kërkuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve Petraq Curri, Ergys Selmani, Ahmet Jangulli dhe Ken Dhima, me pretendimin se kanë kryer shkelje të ndryshme gjatë ushtrimit të detyrës. Për këtë çështje KLD do të mbledhet ditën e hënë. Megjithatë, një kërkesë e tillë pritet të ketë fatin e shumë kërkesave të tjera, të firmosura nga ministrat e Drejtësisë, që pas vitit 2013, të cilat janë hedhur poshtë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, organi i cili nuk gëzon as besimin e shumicës së shqiptarëve dhe as të ndërkombëtarëve, por vetëm të Partisë Demokratike. Nëse sipas Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, organi bazë të Vetëgjykatës, nga katër gjyqtarë të kontrolluar tre nuk duhet të shërbejnë në sistemin e drejtësisë, KLD gjatë gjithë këtyre viteve, ka përfunduar nga sistemi i drejtësisë një numër të papërfillshëm gjyqtarësh. Pavarësisht sinjaleve që po vijnë nga procesi i Vetëgjykatës, KLD duket se do të vijojë deri ditën e fundit, kur të shkrihet si institucion, mbrojtjen e gjyqtarëve. Në mbledhjen e parafundit, zhvilluar në 24 janar 2018, KLD ka rëzuar 13 kërkesa të ngjashme të ministres së Drejtësisë, për shkarkimin e 13 gjyqtarëve. Gjatë kësaj mbledhjeje, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjini Gjoni, ka mbajtur një diskutim të gjatë, duke argumentuar se pse KLD nuk mundet dhe nuk duhet t'i shkarkojë gjyqtarët. Për vetë Gjini Gjoni, Ministria e Drejtësisë, në vitin 2014, i pati kërkuar KLD që ta shkarkonte nga detyra, me pretendimin se ka fshehur pasurinë si dhe ka bërë deklarime të rreme të pasurisë. Ashtu siç pritej, KLD e hodhi poshtë kërkesën e ministrit të atëherëshëm të Drejtësisë. Ndërkaq, në mbledhjen e parafundit të KLD, Gjini Gjoni ka pohuar se me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re dhe të ligjeve të reja për pushtetin Gjyqësor e drejta për të proceduar një gjyqtar është e papërcaktuar.

'LEKSIONI' I GJINI GJONIT NË KLD

Dilema për KLD

Unë diskutimin tim do e bëj në parim në lidhje me disa probleme të cilat duhet të diskutojmë dhe t'i ndajmë sot përfundimisht. Aspekti i parë,



është e vërtetë që janë sjellë një numër i madh procedimesh disiplinore në lidhje me një kategori gjyqtarësh prej 13 vetash sot. Problemi shtrohet dhe i gjithë diskutimi do ndahet në dy kategori. Pjesa e parë ka të bëjë, cila nga dispozitat ligjore sot ky Këshill i Lartë i Drejtësisë duhet të zbatojë? Duhet të zbatojë Kushtetutën e cila është shfuqizuar dhe ligjin 'Për organizimin e pushtetit gjyqësor' i cili është shfuqizuar? Apo ligjin aktual i cili është në fuqi? Në rast se i referohemi Kushtetutës së kaluar dhe ligjin "Për organizimin..." dhe njëkohësisht edhe dispozitave tranzitore, është e vërtetë që Kushtetuta ka parashikuar disa raste të shkarkimit të gjyqtarëve nga detyra.

KOMPETENCA

Problemi është që në fazën e re ku jemi në momentin aktual ku jemi, të drejtën e procedimit edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së re dhe të ligjeve të

reja për pushtetin gjyqësor ka një moment i cili është evaziv dhe momenti është i përcaktuar. Ministrja e Drejtësisë kishte të drejtë që të paraqiste pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në shkurt të vitit 2016, në mos u gabofsha, kishte të drejtë të paraqiste procedimet disiplinore. Tagri, pas këtij momenti i kalon Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të merrte të gjithë tagrat për fillimin e procedimeve disiplinore dhe njëkohësisht edhe për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

PROCEDIM PENAL

Të shkojmë tek momenti i dytë. Momenti i dytë, Kushtetuta e re, në nenin 140, ka përcaktuar dy momente kryesore. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë kur a) ka kryer shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe fig-

urën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë... Tani, të kalojmë tek momenti i parë. Kategorinë e personave që aktualisht janë sjellë për procedim disiplinor prej 13 vetash, unë do e ndaj në dy momente. Momentet e para janë... kategorija e parë janë për shkak të deklarimit të pasurisë dhe që, ashtu siç e diskutuam edhe në mbledhjen e kaluar rezultojnë që këta për deklarimin e pasurisë, ndaj këtyre ka pas një vendim penal dhe do shohim cilësinë e vendimit penal dhe a mund të lidhet çështja penale me çështjen administrative në rastin konkret për procedimin disiplinor. Dhe rasti i dytë është për çështje të cilat diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit. Këto janë dy momente. Të marrim momentin e parë dhe të konsiderojmë që çështja penale është e lidhur me një çështje civile. Po t'i referohesh ndryshimeve të reja në ligj, e ka thënë në mënyrë taksative që çështja e procedimit disiplinor administrativ është e lidhur me çështjen penale dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk mund të veprojë në mënyrë absolute në rast se ka një procedim penal.

MASAT DISIPLINORE

Tani vijmë tek momenti i dytë. Është e vërtetë që një pjesë e gjyqtarëve të cilët janë sjellë sot përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë kanë një sërë shkeljesh dhe normalisht Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të japë një mesazh në lidhje me këto shkelje. Problemi është, në rast se sot ky Këshill i Lartë i Drejtësisë do vendosë që në disa raste të cilët një pjesë e këtyre kanë shkelje të një kate-

gorie që ndoshta nuk futen tek shkarkimi i detyrës por hyjnë tek kategoria e atyre shkeljeve që mund të jetë "Vërejtje me paralajmërim", "Ulje në detyrë", "Ulje në pagë", "Vërejtje e thjeshtë". Vendimi I Gjykatës Kushtetuese me nr. 34 i vitit 2017 i ka shfuqizuar të gjitha këto masa disiplinore. Në rast se ne, ky Këshill i Lartë i Drejtësisë sot - të them të drejtën është në minimumin e kuorumit të vet ligjor, duke qenë se një pjesë e madhe e tyre nuk kanë ardhur - do vendosë që të rëzohet masa e parë disiplinore "Shkarkimi nga detyra", atëherë, cila do jetë masa e dytë që do propozohet? - shtrohet pyetja. Në këtë vakum ligjor i cili është, a mundemi ne që ekstra proceduralisht të marrim një masë tjetër e cila mund të jetë "Vërejtje me paralajmërim", "Ulje në detyrë" ose "Transferim në një gjykatë tjetër" ose këto masat e tjera që janë parashikuar? Në pikëpamjen time, unë them jo.

NDËRRHYRJA E PARLAMENTIT

Dhe cila është arsyeja? Vendimi nr. 34 i Gjykatës Kushtetuese i ka shfuqizuar të gjitha masat e tjera disiplinore të cilat janë parashikuar në ligjin specifik. Shkeljet, më fal. Shkeljet. Dhe duke qenë se ka shfuqizuar shkeljet, cila shkelje do t'i korrespondojë masës së caktuar? Dhe i vetmi moment janë vetëm momentet e shkarkimit, të cilët ky Këshill mund t'i referohet drejtpërdrejt Kushtetutës. Rastet e shkarkimit sipas Kushtetutës, unë i përmenda. Është rasti kur kryen shkelje të rëndë diskrecionit, pozitës dhe figurës së gjyqtarit. Kështu që, në këtë pikëpamje, duke qenë se, unë them që ka një vakum ligjor për sa i përket shkeljes dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka orientuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Parlamentin që të hyjë institucionalisht dhe të rregullojë këtë lloj shkelje. Ndodhemi në një bazë vakumi ligjor në marrjen e kësaj mase.


PROCESI I VETINGUT

Se çfarë do na ndodhë? Ky Këshill i Lartë i Drejtësisë, për një periudhë kohore të gjatë, ka arritur që të shkarkojë deri në momentin aktual një numër, të paktën 10-15 gjyqtarësh deri në momentin aktual. Pavarësisht se nuk është ndonjë çudi e madhe sepse publiku, për shkak të këtij pompoziteti dhe propagandë që është komentuar dhe trumtuar, kërkon që 80% e gjyqtarëve të dalin jashtë sistemit. Por në momentin aktual, kur efektet e

Detajet



KËRKESA
Ministria i Drejtësisë i ka kërkuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve Petraq Curri, Ergys Selmani, Ahmet Jangulli dhe Ken Dhima, me pretendimin se kanë kryer shkelje të ndryshme gjatë ushtrimit të detyrës.



PARALAJMËRIMI
Në mbledhjen e parafundit të KLD, Gjini Gjoni ka pohuar se me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re dhe të ligjeve të reja për pushtetin Gjyqësor e drejta për të proceduar një gjyqtar është e papërcaktuar.

deklarimit të pasurisë, efektet e kontrollit të vlerësimit dhe rivlerësimit të gjyqtarëve janë në fazat fillestare dhe Komisionet e Pavarura të Kualifikimit dhe Komisioni i Apelimit po marrin në sitë të gjithë gjyqtarët, unë them, edhe për shkak të vakuumit ligjor, le t'i ndajmë këto dy kategori: kategorinë e parë të cilët janë për shkak të pasurisë dhe kategorinë e dytë për shkak të shkeljeve dhe në fund, po që ky Këshill i Lartë i Drejtësisë të pezullojë çështjet sepse ka një vakum ligjor dhe t'i kalojë KLD-së ose këtij Këshilli në rast se Kuvendi i Shqipërisë, brenda një periudhe kohore të shkurtër, riparimet defektet e ligjit dhe shfuqizimit që ka dhënë Gjykata Kushtetuese. Pasi edhe ne çmojmë besoj edhe kolegët anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ndajnë të njëjtin mendim me mua që, për ata gjyqtarë të cilët ka shkelje, ne duhet të japim atë që meritojnë. Për ata gjyqtarë të cilët janë në rastet të cilat ligji nuk i parashikon mund të shpëtojnë edhe nga ndonjë ndëshkim i mëvonshëm për shkak të mungesës së këtij ligji. Kjo është pikëpamja ime. Unë diskutimin e bëj në parim. Nuk e bëj për persona konkret dhe për emra nominal.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "REAL BAILIFF SERVICE" SH.PK DO TË ZHVILLOJË ANKANDIN E PARË PËR PASURINË E PALUAJTSHME:

1. Are me Nr. Pasurie 37/14 Volum 7, Faqe 5, Zonë kadastrale 1198, me sipërfaqe 18,360 m², me vendodhje Bisht Kamez, Katund i Ri, Durrës, në pronësi të Lame Idrizaj, mbi të cilën është vënë hipotekë për shumën 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) Leke. Çmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 6,480,000 (gjashtë milion e katerqind e tetëdhjetë mijë) LEKË.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e shoqërisë "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 15.05.2018 në orën 16:00, në adresën: Rr. "Myslym Shyri", Vila 8/1, Kati 4, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: resulalushani@gmail.com

29 PRILL 2018

Lëvizja e Osmanit drejt shqipërisë është konfirmuar edhe në sistemin TIMS, ku ky person me makinën e tij tip "Volkswagen Turan", është rregjistruar në pikën kufitare të Morinës, në datën 29 prill 2018

ELTON QYNO
TIRANE

Një 61-vjeçar nga Mitrovica e Kosovës, mendohet se është djegur plotësisht brenda makinës së tij në fshatin Derven, të Fushë-Krujës. Xhafer Osmani, tre ditë më parë është raportuar i zhdukur nga familjarët e tij në policinë Kosovare, të cilët kanë denoncuar se familjari i tyre, u ka pohuar se do largohet në Shqipëri, pasi kishte një punë. "...është larguar duke na thënë se kam një punë në Shqipëri, dhe duhet ta mbyll patjetër...". Kështu kanë deklaruar familjarët e Xhafer Osmanit në policinë Kosovare. Lëvizja e Osmanit drejt Shqipërisë është konfirmuar edhe në sistemin TIMS, ku ky person me makinën e tij tip "Volkswagen Turan", është rregjistruar në pikën kufitare të Morinës, në datën 29 prill 2018. Pas kësaj date hyrje në tritorin shqiptar, nuk ka asnjë të dhënë se ku ka shkuar 61-vjeçari nga Kosova, dhe se me cilin person është takuar dhe për më tepër ku ka qëndruar gjatë natës dhe ditës. Makina e tij është konstatuar e djegur në fshatin Derven, ku kanë qënë banorë të zonës të cilët kanë njoftuar për praninë e makinës së djegur dhe ekzistencën e një trupi të pidentifikuar brenda saj. Në vendgjarrje kanë shkuar efektive të policisë së Krujës dhe komisaritit Fushë-Krujë, të cilën nën drejtimin e prokurorit të rethit Petrit Cano, kanë nisur hetimet për të mësuar rrethanat e mëtejshme të kësaj ngjarje, tepër misterioze. Për momentin thanë burimet nuk dihet me saktësi të plotë nëse viktima mund të jetë Xhafer Osmani ose jo, pasi ka dyshime se në automjet mund të ketë qënë dhe person tjetër. "Për momentin jemi duke bashkëpunuar me

policinë e Kosovës, e cila na ka konfirmuar të na sjellë informacion dhe kampione biologjike të familjarëve të Xhafer Osmanit, me qëllim kryerjen e analizave të ADN për identifikimin e trupit të djegur plotësisht"-tha një burim për gazeta "Shqiptarja.com". Ndërkohë nga ana tjetër, policia e zonës gjatë ditës së djeshme ka vijuar punën e mbledhjen e informacionit operativ, për të mësuar se në cilin hotel apo banesë në këtë zonë mund të jetë strehuar kosovari. "Jemi duke verifikuar disa pista hetimi. Kemi të dhëna se Xhafer Osmani mund të ketë mbëritur në Shqipëri, pasi dyshojmë në një variant se ai kishte krijuar një lidhje intime në Shqipëri dhe për pasojë qëllimi i këtij udhëtimit mund të ketë qënë

një histori intime, që më pas ka përfunduar në tragjedi"-thënë burimet nga policia. Por këto të fundit shtojnë se në këtë pistë janë duke punuar duke kërkuar informacion

nga pala Kosovare dhe verifikuar adresat elektronike të Xhafer Osmanit. Ndërkohë që një tjetër pistë ku policia dhe prokuroria e Krujës janë përqëndruar është dhe ajo e

një variant të mundshëm të një grabitje. Shtetasi Kosovar mund të jetë sulmuar nga persona ende të pidentifikuar dhe më pas është vlarë. Ndërkohë autorët për të veshur

krimin me mister, mund ta kenë transportuar viktimën në zonën e pabanuar dhe pikërisht aty i kanë vënë zjarren makinës, për të zhdukur çdo gjurmë të mundshme.

Misteri, kosovari gjendet i vdekur në makinën e djegur

"Do iki në shqipëri se kam një punë", viktima Xhafer Osmani u raportua i zhdukur në Kosovë. Dyshime për një lidhje intime



Deklarata

"...është larguar duke na thënë se kam një punë në Shqipëri, dhe duhet ta mbyll patjetër...". Kështu kanë deklaruar familjarët e Xhafer Osmanit në policinë kosovare.




Bashkëpunimi

"Për momentin jemi duke bashkëpunuar me policinë e Kosovës, e cila na ka konfirmuar të na sjellë informacion dhe kampione biologjike të familjarëve të Xhafer Osmanit, me qëllim kryerjen e analizave të ADN për identifikimin e trupit".

NGJARJA NË SHKODËR

Projekti i rrugës i prek lokalit, pronari plagos supervizorin e firmës

Ndërtimi i rrugës nacionale Shkodër-Velipojë ka çuar në plagosjen me armë të supervizorit të firmës e cila po kryen punimet në këtë aks rrugor. I plagosur ka mbetur Xhevat Vataksi 60 vjeç, i cili është konfliktuar me pronarin e një lokalit në fshatin Dragat të Shkodrës. Sipas informacioneve, shkak i konfliktit ka qënë dëmtimi i një pjese të lokalit të shtetasit Artur Lushi 43 vjeç, nga zbatimi i projektit të firmës zbatuese për rikonstruksionin e rrugës. Fillimisht biznesmeni Vataksi i cili është edhe si supervizor ndërtimi, ka debatuar me 43-vjeçar, Artur Lushi, për çështje shkatërrimit të një pjese të parkingut dhe në debat e sipër ky i fundit ka nxjerr armën e zjarrit tip pistoletë dhe e ka qëlluar në këmbë biznesmenin 60-vjeçar Xhevat Vataksi. Menjëherë pas ngjarjes është njoftuar policia dhe ambulanca ku biznesmeni është dërguar me urgjencë drejtë spitalit të Shkodrës. Sipas mjekëve 60-vjeçari është plagosur në këmbë dhe është jashtë rrezikut për jetë. Ndërkohë policia ka shpallur në kërkim autorin e kësaj ngjarje, 43-vjeçarit Artur Lushi i cili është arratisur pas plagosjes së kryer.



MALËSI E MADHE

Sherr mes fqinjëve, dy vëllezërit plagosin 32-vjeçarit Ylli Berisha

Plagosje me armë zjarri edhe në Malësinë e Madhe mesditën e kësaj të shtunë. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Kamicë, pas një konflikti të çastit ku është plagosur Ylli Berisha, 32 vjeç, banues në fshatin Kamicë, Malësi e Madhe. Në kërkim janë shpallur dy vëllezërit L. H 42 vjeç, dhe L. H. 48 vjeç. Autorët janë fqinjë me të plagosurin, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Policia është vënë në ndjekje të dy vëllezërve dhe po punon për arrestimin e tyre. "Menjëherë janë vënë në lëvizje të gjitha shërbimet e policisë duke rrethuar zonën ku kanë bërë të mundur identifikimin dhe po punohet për kapjen e autorëve, shtetasit L. H 42 vjeç, dhe L. H. 48 vjeç (vëllezër). Shtetasi Y. B. ndodhet në Spitalin Rajonal Shkodër, jashtë rrezikut për jetën. Në vendgjarrje ndodhen shërbimet e policisë, dhe grupi hetimor po punohet për sqarimin e rrethanat të ngjarjes"-thuhet në komunikatën e policisë së Shkodrës.



Shoqëria Përmbarimore "ZIKE" sh.p.k

ZIKE

me adresë: Blv.Gjergj Fishta" Pallatet "Gora" Kulla 2, Kati 2, Ap 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi si më poshtë: Vënë në Hipoteke për Bankën "CREDINS" sha për shumën 7,126,490 lekë.

- Në datë 25.05.2018 ora 16:30

-Pasuri nr. ZK 8531, lloji i pasurisë (apartament) me sip. 98,79 m2, me adresë Lagja "Kryengritja e Fierit" Fier, në pronësi të z.Gezim Ndue Prendi dhe znj.Arta Nikolle Prendi, çmimi fillestar është 22,128,96 Euro
-Pasuri nr. ZK 8533, lloji i pasurisë (apartament) me sip. 56,5 m2, me adresë Lagja "8 Shkurti" Fier, në pronësi të znj.Alime Dervish Habilaj dhe z.Gramos Femi Habilaj, çmimin fillestar është 11.117,68 Euro.

Për informacione mund të kontaktoni në numrin e Tel. 044 500 278 ose adresën e e-mailit: ilirdervishi85@gmail.com

Do korruptonin me 250 mijë lekë gjyqtarin e Beratit dënohen sekseseri e qytetari

Gjykata e Beratit ka dënuar me 6 muaj dhe 8 muaj burg, Gjergji Bumblin dhe Mati Simonin

ELTON QYNO
TIRANE

Një dosje e nisur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për korruptimin e një gjyqtari në Berat, por që më pas çështja u sfumua dhe materiali hetimor i kaloi prokurorisë së Beratit, është mbyllur me dënimin e dy të pandehurve të kësaj çështje. Mati Simoni dhe Gjergji Bumblin, janë dënuar përkatësisht me 6 dhe 8 muaj burgim për akuzën e "Ushtimit të ndikimit ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", siç ishte rasti i një gjyqtari në Berat. Dy personat e sipërcituar janë përgjuar nga prokuroria, teksa po tentonin të korruptonin kundrejt 250 mijë lekë të vjetra, gjyqtarin e Beratit, Kostika Çobanaqi, i cili kishte në gjykim të pandehurin Mati Simoni, në një çështje tejtër, ku akuzohej për akuzën e "Shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale". Për këtë akuzë Simoni është dënuar me 600 mijë lek të vjetra gjobë nga gjyqtari i Beratit, Kostika Çobanaqi, por prokuroria kishte dyshime se ky vendim ishte paracaktuar më parë, pikërisht në zyrën e këtij gjyqtari. Kjo pasi në disa biseda të përgjuara dhe vëzhgime në teren, Mati Simoni dhe Gjergji Bumblin flisnin për një pazar dhe punë, që duhet të zgjidhnin në gjykatën e Beratit. Aq më tepër që në këto biseda, qartësohet dhe katër mundësitë e dënimit të Mati Simonit, ku personi që kishte dalë garant për ti ndihmuar, i kishte pohuar se do zgjidhte me variantin e katërt, që do të thoshte dënim me punë të detyruar në komunitet. Pas mbylljes së pazarit, Gjergji Bumblin telefonoi Mati Simonin duke i thënë: "... ej, çun çun dhe me yje në ballë, doli djalë muhabeti..." duke nënkuptuar se gjithçka ishte zgjidhur pozitivisht. Por me sa duket mbas mësimit mbi hetimet që po kryente policia dhe prokuroria, vendimi i dënimit të Mati Simonit nuk ka qënë sipas variantit të katërt, por sipas variantit të dytë, që do të thoshte dënim me gjobë dhe jo me dënim punë të detyruar në komunitet. Për të sqaruar rrethanat e këtij moment është thirrur dhe është pyetur në prokurori gjyqtari



Kostika Çobanaqi. Gjatë vitit 2016 ai thotë se ka dhënë rreth 400 vendime, por për rastin në fjalë, gjyqi i shtetasit Mati Simoni nuk i kujtohet. Për sa i përket pretendimit, që i pandehuri Gjergji Bumblin ka hyrë në zyrën e tij dhe ka biseduar me të në lidhje me arrijten e një kompromisi për një dënim të butë ndaj Mati Simonit, gjyqtari deklaroi gjatë fazës së hetimit se kjo gjë nuk qëndron dhe nuk është e vërtetë. Ai, pretendoi se nuk ka biseduar me shtetasin Gjergji Bumblin në zyrën e tij dhe në asnjë vend tjetër. Për shkak të mungesës së provave, prokuroria nuk ka vepruar marenj të pandehur të gjyqtarit Çobanaqi, por ka akuzuar për "Ushtimit të ndikimit ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" dy personat Mati Simoni dhe Gjergji Bumblin.

"Shqiptarja.com" sjell të plota bisedat e përgjuara mes Mati Simonit dhe Gjergji Bumblit, si dhe mesazhet e shkëmbyera mes tyre, ku tregohen përpjekjet intensive për të dalë "pa lagur" nga kjo çështje.

PËRGJIMI I 17 NËNTORIT 2016

Gjergji: he vlla..
Mati: he Gjergj si ke një
Gjergji: mir, mir, car po bën, sot mar përgjigjen e saktë, sot
Mati: hajd ta marsha të keqen, n'mujsh me ma bo at pun
Gjergji: hajde pa merak fare, pa merak fare do të mar un
Mati: shnt pra, shnet zemër, hajd.

BISEDA E DYTË NË TË NJËTËN DITË

Gjergji: he vlla ;

Mati: o vlla ku je te henksa zemren, ku je
Gjergji: ej, çun çun dhe me yje në ballë
Mati: eeee
Gjergji: djal djal
Mati: djal
Gjergji: po ore
Mati: aaa të lumt, falemnners prej teje
Gjergji: ej po dua të flas un në telefon si bëjmë këto muhabet
Mati: mir në rregull
Gjergji: vajta fola vetë gojarisht me personin, nga atje po kthehem
Mati: po po
Gjergji: edhe më ka lënë nja 4 detyra të bukura, në 4 detyra në do të zgjedhim njëerën, të fundit;
Mati: hajd mirë ta marsha të keqen, shumë falemnners prej teje e ki problem ti vetëm të marohet puna
Gjergji: degjo, dua të flas gojarisht se në telefon nuk ti sqaroj dot
Mati: mirë në rregull, ta po vij vetë anej matanë, nga java tjetër po vij unë.
SMS e datës 17 nëntor mr tekst: "...kemi 4 varijante denimi 1. dënim me burg, 2. dënime me gjobë, 3. dënim me kusht, 4. dënim me punë në komunitet dhe ai miku këtë të fundit më sugjeroj ok...".

BISEDA E PËRGJUAR NË 21 NËNTOR 2016

Gjergji: he mo vlla
Mati: he more shtet çar bone, a ke atje
Gjergji: po mor keva mor burrë
Mati: çfar të thanë a gja
Gjergji: çar bona, pagova nja 500 mijë lekë për atë ditë me një fjal të enjten
Mati: 200 kam pagu un për patent, ti thu
Gjergji: se kena met pa gja .

PËRGJIMI I DATËS 24 NËNTOR 2016

Gjergji: he vlla, a je te spitali
Mati: sa mbarova serumet dhe erdha për shpi. Çar bëre
Gjergji: jo mor nuk u bo gja mor burr, na rras gjob mor burr
Mati: çar thua ti ere
Gjergji: po për shpirt të babës 600 mijë lek
Mati: gjob 600 mij lek??
Gjergji: po
Mati: po pse
Gjergji: nuk di gja un mor vlla
Gjergji: hajd se do të flasim prap se un ato nuk ja kam dhën, un i kam me vete ato
Mati: hala nuk ja ke dhanë ato
Gjergji: po, po, po nuk ja kam dhën, i kam un ato, e kupton, mos ma vrit mendjen për asnjë gjë pastaj
Mati: po pse dreqin nuk ja ke dhën
Gjergji: jo, jo më tha do flasim se fola në telefon, e kupton
Mati: kur fole në telefon, njitash me ta
Gjergji: jo, jo fola parëmbremë në darkë e më tha është i mbaruar ai muhabet,e kupton,

REPUBLICA E SHQIPËRIE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

Gj : sherbimi i proves ka shume gjera, ajo eshte punë e zakonshme, ca te beja une. Kur prokurori te ka kerkuar 2 milion e 600 mijë, kerkuar prokurori ;

M : po prokurori ashtu tha, se harroj ;

GJ : ti ere nga 2.5 milion sa ta ka lene ty ;

M : 600 mije tha me pagua, do ti paguaj ca kam me pagua ;

Gj : se ai nuk te ka as mik as shok, s 'te njej fare ;

M : me gjyqtarin po ;

Gj : muhabeti per mua eshte i mbyllur, mos e vrit mendjen ;

M : une hem anej e hem knej, tashi dreqi e hang e hang ;

Gj : nuk ke pune, tani vazhdo punen tende, kaq shpejt ;

*Kopje te formulareve te regjistrimit te numrit te regjistrimit i kompanise "Vodafone Albania" shënimet 0693811685 i perket abonentit/perdoruesit Mati Simoni ;

2.Formulari i regjistrimit i kompanise "Vodafone Albania" telefonit 0695517514 i perket abonentit/perdoruesit "13 shtatori" Berat.

*Procesverbal i deklarimit te shtetases Alma Simoni e martuar me shtetasin Mati Simoni, te cilin e duhanit.Ne lidhje me njohjen e shtetasit Gjergji Bumblin thote gje, ndoshta po ta shoh mund ta kujtoj qytetari se e njoh kete shtetas si bleser duhani ne qytet ;

Ne lidhje me takimin/biseden nuk mbaj mend ne duhanin.Burri im Mati Simoni ka patur ne duhanit cilin ka qene i pandehur per kryerjen e veprave te ndaluar nga policia e Beratit. Ne, nuk kemi mundur te gjykojmë se Berati e cila ne fund te vitit 2017 Gjergji Bumblin nuk ka qene ;

*Procesverbal i deklarimit te shtetases Alma Simoni e martuar me shtetasin Mati Simoni, te cilin e duhanit.Ne lidhje me njohjen e shtetasit Gjergji Bumblin thote gje, ndoshta po ta shoh mund ta kujtoj qytetari se e njoh kete shtetas si bleser duhani ne qytet ;

Ne muajin maj 2017, gjyqtari i Beratit, Kostika Çobanaqi, i cili kishte në gjykim të pandehurin Mati Simoni, në një çështje tejtër, ku akuzohej për akuzën e "Shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale". Për këtë akuzë Simoni është dënuar me 600 mijë lek të vjetra gjobë nga gjyqtari i Beratit, Kostika Çobanaqi, por prokuroria kishte dyshime se ky vendim ishte paracaktuar më parë, pikërisht në zyrën e këtij gjyqtari. Kjo pasi në disa biseda të përgjuara dhe vëzhgime në teren, Mati Simoni dhe Gjergji Bumblin flisnin për një pazar dhe punë, që duhet të zgjidhnin në gjykatën e Beratit. Aq më tepër që në këto biseda, qartësohet dhe katër mundësitë e dënimit të Mati Simonit, ku personi që kishte dalë garant për ti ndihmuar, i kishte pohuar se do zgjidhte me variantin e katërt, që do të thoshte dënim me punë të detyruar në komunitet. Pas mbylljes së pazarit, Gjergji Bumblin telefonoi Mati Simonin duke i thënë: "... ej, çun çun dhe me yje në ballë, doli djalë muhabeti..." duke nënkuptuar se gjithçka ishte zgjidhur pozitivisht. Por me sa duket mbas mësimit mbi hetimet që po kryente policia dhe prokuroria, vendimi i dënimit të Mati Simonit nuk ka qënë sipas variantit të katërt, por sipas variantit të dytë, që do të thoshte dënim me gjobë dhe jo me dënim punë të detyruar në komunitet. Për të sqaruar rrethanat e këtij moment është thirrur dhe është pyetur në prokurori gjyqtari

Jo, nuk kam mundur te gjykojmë se Berati e cila ne fund te vitit 2017 Gjergji Bumblin nuk ka qene ;

Une, me shprehur qytetari se e njoh kete shtetas si bleser duhani ne qytet ;

Gj : degjo nje cike. thene qe ka kerkuar folem ne.Nuk e detyruar ;

A : Matia, Matia e ka kerkuar por te detyruar. Duhet te tregohet brenda.....Ne kemi te detyruar 600 mije leke, shqyrtohet ne Vlore e Berat ;

A : mire o Gjergj, mire...
Gj : prokurori e kishte le...
A : po, 2 milion e gjysem...
Gj : ee pra. Une tha kam le...
A : i lumte per at pune ;

Gj : e kuptoni tani, une te ka shkrim dore..... ;
A : ne na met faj, ajo pune m...
Gj : jo, jo nuk me kerkoj ate q...
A : normal, ne nuk dishim as m...
Gj : Jo, jo une ja u spjegova edhe ne komunitet, dy ore ne dite, ja...
A : ai se ka kuptu ;

-Shtetasi Mati Simoni telefonoi Gjergji Bumblin duke i thënë: "... ej, çun çun dhe me yje në ballë, doli djalë muhabeti..." duke nënkuptuar se gjithçka ishte zgjidhur pozitivisht. Por me sa duket mbas mësimit mbi hetimet që po kryente policia dhe prokuroria, vendimi i dënimit të Mati Simonit nuk ka qënë sipas variantit të katërt, por sipas variantit të dytë, që do të thoshte dënim me gjobë dhe jo me dënim punë të detyruar në komunitet. Për të sqaruar rrethanat e këtij moment është thirrur dhe është pyetur në prokurori gjyqtari

Gj : kam folur me dy avokat te cilin te behet amnisti tani ne dhjetor e janar ;

M : faleminers mo zemer.... o bo ca...
Gj : ai te beri ty fajtor, duhet ta kishit...
M : po ca ditë me me kerku, une i th...

Përgjimet: Doli djalë me yll, por na rراسi gjobën more burrë

Zbardhen përgjimet, dyshohet se do korruptonin gjyqtarin Kostika Çobanaqi, por gjyqtari e mohoi

mo. ma vrit mendjen se do ti rregulloj të gjitha, ato do ti kthej un do ti jap prap ato.

Mati: po un nuk i kam marrë me i kthy mor, un për njëkët pun i kam ashtu, po shyyr se je mir.

BISEDË E PËRGJUAR NË 24 NËNËTOR

Mati: a nuk ja ke dhan leket perpara mor burr a ;

Gjergji: fola në telefon, i kam unë lekët, i kam unë nuk ja kam dhën akoma se fola tha do të flasim tha, i kam un lekët.

Mati: po duhet me pague 600 mijë lek mor burr, si me ja bo tash

Gjergji: lërma ta s'qaroj un këtë muhabet.

Mati: hajd mir pra, un duhet me i pagu mor burr, ai po ma bjen letrën për Shkodër, duhet me i pague të tana për shpirt të babës.

Gjergji: në rregull hajde kur të duash.

BISEDË E PËRGJUAR NË 30 NËNËTOR 2016

SMS dërguar nga Gjergji tek Mati: "...o vlla me atë mikun këtu mbarova punë ja dhash kafen sipas fjalës 250 ok...".

Mati: hë more kapedan, a je mirë, hiç për zotin.

Gjergji: hë, mirë ke qenë

Mati: hë

Gjergji: e i vajta atje dhe i lashë ato në tavolinë urdhëro i thashë në daç shumë në daç pak, ou më tha mua pse ma bëre kshu. Po pse si do ta bëj i thash un. Pse ma bëre kshu, e kupton.

Mati: sa i le mor zemër

Gjergji: dy e gjysëm

Mati: pash zotin, hajt mirë pra mirë

Gjergji: ia lashë në tavolinë. I thash si shumë si pak thashë un të jem borxhli i thashe unë për herë tjetër. Pse ma bëre kshu tha, e kupton.

Mati: po mirë zemër, hajt të lumtë dora pra. Hajt pra se ta po rregullohena bashkë pra mo vlla.

Bisedë e përgjuar në dhjetor 2016

Gjergji: po hajt se do kalojnë ato, kaluan kaluan

Mati: haj hajt, shyyr që je mirë

Gjergji: dëgjo tani, tani sa dola nga ai miku dhe fajin ta ka vënë ty, se nuk e ke kërkuar ti. Ti i ke thënë shërbim prove, po shërbimi i provës ka disa gjëra. Vetëm i binte që tja thosha troç. Unë troc nuk ja thosha dot, tha e kupton...

Mati: po

Gjergji: duhej t'ja kërkoi ti dhe kemi një favor tjetër, tani do ta apelojmë në Vlorë a në Tiranë. Apelimi shkon një vit e ca dhe mbas një vit e ca, shkon o gomari o i zoti dhe gjoba ka të drejtë të hyj automatikisht mbas një viti, kur të mbaroj apeli, që do më thënë, nuk do paguajmë asgjë, asnjë gjobë...

Mati: oo Gjergj

Gjergji: puna e ankimit ka të drejtë nga kjo e sot, ka 10 ditë kohë.

Mati: nuk mund ti hij më kësaj pune se nuk kam ashu... për shpirt të babës o Gjergj...

Ndërhyn shtetesia Alma Simoni,

bashkëshortja e shtetasit Mati Simoni:

Gjergji: dëgjo një çikë. Tani dola nga zyra dhe fajtor ai ka bërë tët shoq që i ka thënë pse i ka thënë që ka kërkuar atë. Unë nuk mud ta detyroj sepse e ka kërkuar ai këtë punë. Atë që folëm ne. Nuk e detyroj unë qytetarin, është qytetari që kërkon atë, kupton.

Alma: Matia, Matia e ka kërkuar dje.

Gjergji: e ka kërkuar por ka kërkuar shërbim prove vetëm. Shërbimi i provës ka këtë punë, punë të detyruar. Duhet të thoshte punë me detyrim, se ka disa gjëra shërbimi i provës brenda.....Ne kemi të drejtë brenda 10 ditë të ankimojmë vendimin që nuk jemi dakord me gjobën 600 mijë lekë, sepse nuk kam lekë dhe kjo ikën në Vlorë. Ajo do një vit e gjysëm të shqyrtohet në Vlorë e brenda kësaj kohe ne nuk paguajmë asgjë.

Alma: mirë o Gjergj, mirë

Gjergji: prokurori e kishte lënë 2 milion lekë gjobë.

Alma: po, 2 milion e gjysëm

Gjergji: ee pra. Unë tha kam bërë me minimumin, me minimumin tha

Alma: i lumtë për atë punë

Gjergji: e kuptoni tani, unë të kam lënë 600 mijë lek tani, futi dy gisht letër, bëj ankimin vetë me shkrim dore.

Alma: ne na met faji, ajo punë me dije

Gjergji: jo, jo nuk më kërkoi atë që tham ne, nuk e kërkoi ai

Alma: normal, ne nuk dishim as me kërkue ti u bone.

Gjergji: Jo, jo unë ja u spjegova edhe ti ishe në tavolinë me Matin, dua punë me detyrim, punë në komunitet, dy orë në ditë, ja kaq

Alma: ai se ka kuptu.

Shtetasi Mati Simoni telefon shtetasin Gjergji Bumbli

Gjergji: kam folur me dy avokat të cilët më thanë as ankimit mos bëni as gjobë mos beni, se do të bëhet amnisti tani në dhjetor e falen të gjitha.

Mati: faleminers mo zemer.... o bo ca bo nuk kam ca ma thon mo.

Gjergji: ai të bëri ty fajtor, duhet ta kishe kërkuar ti at punë.

Mati: po ca dita unë me kërkue, une i thash shërbim prove.

Gjergji: shërbimi i provës ka shumë gjëra, ajo është punë në komunitet. Kur nuk e kërkon ai, tha ca të bëja unë. Kur prokurori të ka kërkuar 2 milion e gjysëm ty gjobën. E di ti sa të ka kërkuar prokurori.

Mati: po prokurori ashtu tha, se harroj

Gjergji: ti ere nga 2.5 milion sa ta ka lënë ty

Mati: 600 mijë tha me pagua, do ti paguaj ca kam me ba.

Gjergji: se ai nuk të ka as mik as shok, s'të njeh fare se kush je

Mati: me gjyqtarin po

Gjergji: muhabeti për mua është i mbyllur, mos e vrit më mendjen.

Mati: unë hem anej e hem knej, tashi dreqi e hangërt, unë nuk kam ma....

Gjergji: nuk ke punë, tani vazhdo punën tënde, kaq.

Kokainë në Spanjë, hetime në Lezhë pse bosi Julian Gjoka ndryshoi mbiemrin

Mëshohen detaje të reja nga hetimet që po zhvillohen në Shqipëri pas arrestimit të dy shqiptarëve të cilëve në Spanjë iu kapën 1 ton kokainë dhe 1.5 milion euro cash. Burime nga Policia e Shtetit thonë se për momentin fokusi hetimeve është përqendruar tek të arrestuarit Julian Deblini i cili më parë e ka mbajtur mbiemrin Gjoka dhe Arjan Ndoci. Julian Gjoka në vitin 2011 e ndryshoi mbiemrin në Julian Deblini. Por edhe vëllai i tij rezultoi me mbiemër të ndryshuar. Policia e Lezhës dhe departamenti kundër zbulimit në SHISH janë duke mbledhur informacione përse Julian Gjoka, e ndryshoi mbiemrin. Sikurse edhe lidhjet e të mundshme të 35-vjeçarit nga Lezha me eksponentë të botës së krimit në këtë qytet apo edhe në Europë.

Nis verifikimi pasuror për dy të ndaluarit, pritet sekuestroja e pasurisë



Julian Gjoka



edhe të familjarëve të Arjanit, që rezultojnë bashkëpronarë të një nga Qendrat Tregtare më të rëndësishme në kryeqytet dhe pronar i shumë palateve. Verifikimet bazohen në ligjin antimafia ku përfshihen në hetime edhe familjarët e të arrestuarve për trafik ndërkombëtar droge.

HETIMI PASUROR

Një ditë pas arrestimit zëdhënësja e policisë së Madridit në një prononcim për "Report TV" deklaroi se dy shqiptarët e arrestuar ishin kokat e këtij grupi kriminal ku bënin pjesë edhe dy shtetas spanjoll dhe një kolumbian. Në të njëjtën kohë Prokuroria e Krimeve të Rënda po kryen verifikime në zyrat e hipotekës, bizneset, bankat e nivelit të dytë, pronësitë mbi automjetet dhe agjencitë e transfertave dhe këmbimeve valutore. Pas verifikimeve nga policia dhe prokuroria dosja do kalojë në Gjykatë për vënien e pasurive nën sekuestro, dhe pas sekuestros së pronare ata janë të detyruar ti faktojnë gjykatës origjinën e parave me të cilat kanë ndërtuar këto prona.

NDOCI I MASKUAR ME IDENTITET TË RREMË

Bashkë me Julian Deblinin në Spanjë është arrestuar edhe Arjan

Ndoci, 45-vjeç me origjinë nga Laçi por banues në Tiranë. Momentin e arrestimit ai kishte paraqitur

një pasaportë fals me identitet të Dritan Gradicës, djali i një ish-gjyqtari që jeton në Londër, por që

nuk rezultoi të ketë asnjë lidhje me trafikun. Në sitën e verifikimeve do të kalojnë në fakt të gjitha pasuritë

EKSTRADIMI I ARBËR ÇEKAJT

Brenda tre javësh autoritetet gjermane e sjellin në Tiranë

Arbër Çekaj, pronari i firmës "Arbri Garden", i arrestuar një ditë më parë në Gjermani, pasi dy muaj më parë në kontenierin me banane të firmës së tij u gjetën të fshehura edhe 618 kilogramë kokainë e ardhur nga Kolumbia, pritet të

paraqitet para autoriteteve shqiptare të drejtësisë brenda 10-15 ditëve. Prokurorët thonë se ekstradimi i Çekajt është një procedurë e shkurtër që pritet të kryhet mes zyrës së Interpol Tiranës dhe zyrës homologe në Gjermani. Kjo pasi urdhri i kërimit ndërkombëtar ndaj

Çekajt përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm si dhe vendimin që ndaj tij është caktuar në mungesë masa e sigurimit "arrest me burg". Nisur nga kjo situatë nuk ka nevojë për dokumente shtesë apo dërgime dosjesh. E gjithë kjo procedurë, mund të zgjasë

nga 10 deri në 15 ditë. Kështu, brenda tre javësh Prokuroria e Krimeve të Rënda mund të ketë në dispozicion për ta pyetur njeriun kryesor të dyshuar për trafikimin e ngarkesës rekord të kokainës të kapur ndonjëherë jo vetëm në vendin tonë, por edhe në rajonin e Ballkanit.



Arbër Çekaj

TAKIMI NË ZONËN E BERATIT

I ankohen qytetarët gjatë takimeve Gjonaj shkarkon Drejtorin e Hipotekës

Shkarkohet drejtori i Hipotekës Berat, pas ankesave të qytetarëve në takimin me Ministren e Drejtësisë. Turi i llogaridhënies së ministrave përpara qytetarëve ka sjellë edhe reagimin e parë. Menjëherë pasi është kthyer nga Berati ku ka zhvilluar dy takime në komunat Otllak dhe Velabisht, Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka shkarkuar nga detyra drejtorin e ZVRPP të këtij rrethi, Robert Poçi. Gjatë takimeve në njësitë administrative

të Beratit, banorët kanë shprehur shumë pakënaqësi për punën e Hipotekës dhe madje kanë bërë akuza të drejtpërdrejta për drejtuesin e saj. Burime nga Drejtoria e Përgjithshme e ZRPP thonë se në shkarkimin e Poçit ka ndikuar edhe analiza e praktikave të prapambetura dhe trajtimit të tyre jashtë afateve ligjore.



DËM I MADH EKONOMIK

Ushtria pastron dëborën në rrugës Bogë-Theth, por shikoni çfarë dëmi ka bërë

Rruga automobilistike që lidh zonën malore të Bogës dhe Thethi, e cila prej 6 muaj qëndron e bllokuar për shkak të sasisë së madhe të borës, është shkatëruar. Ky shkatërim nuk ka ardhur nga kushtet atmosferike të motit dhe rreshjeve të shumta të dëborës, por nga mjetet e Forcave të Armatosura të cilat u angazhuan për pastrimin e borës që mbante të bllokuar këtë segment rrugor. Fadromat e ushtrisë që janë përfshirë në pastrimin e rrugës, paralelisht kanë dëmtuar rëndë pjesët metalike anës rrugës, që shërbejnë për mbrojtjen e drejtuesve të automjeteve, në mënyrë që të mos dalin nga rruga dhe të bien në shpatet e thepisura të kësaj zone. Dëmi ekonomik i



shkaktuar nga fadromat e ushtrisë përlogarit në miliona lek, dëmi ky që nuk ka ardhur nga një subjekt privat por nga një institucion shtetëror. Shumë banorë të Thethit dhe Bogës e kanë denocuar dëmtimin e rëndë të pjesëve metalike

në priflet e tyre në FB, ndërkohë nga ana e institucionit përgjegjës, që në këtë rast është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Forcat e Armatosura nuk kanë marrë asnjë masë ndëshkimore për personat përgjegjës.

SARANDË

Fshehu 34 kg lëndë narkotike në banesën e tij, arrestohet

Shtetasi shqiptar A.Selamaj, 51 vjeç është arrestuar pasi ka fshehur 34 kg lëndë narkotike Kanabis Stativa në banesën e tij gjatë një kontrolli të ushtruar nga policia e Sarandës. Policia vijon hetimet, ndërkohë materialet hetimore janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë për veprime të mëtejshme me akuzën "Prodhim, shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283 të Kodit Penal" për shtetasin A.Selamaj banues në lagjen Çlirim të Sarandës.



Prendë Zmalaj

TIRANE

11 vite në varfëri, refuzimi i KEMP-it që penalizoi Prendën

Familja Zmalaj në fshatin Çerkezë të Tiranës jeton në varfëri ekstreme. Përpos kushteve të vështira të jetesës, 56 vjeçares, Prendë Zmalaj, e cila është invalide, edhe e deklaruar nga mjeku, i hiqet kemi duke thëlluar më tepër gjendjen ekonomike të kësaj familje. Për Prendë Zmalaj, jeta nuk është treguar fort bujare. Ajo është 56 vjeçe.

Ka tre djem dhe dy vajza. Për këtë familje vështirësitë nuk njohin të sosur. Asaj i kanë mohuar të drejtën e përfitimit të KEMP-it.

“Jam invalide, përbërja ime familjare është prej 5 vetash, 3 djemve dhe burrë e grua, kam marrë KEMP-in më parë, dy vite i mora në Tiranë dhe KEMP-in ma hoqën, po të isha e aftë punoja në një

fabrike këpucësh. Nuk mundem, madje jam rrëzuar në shtëpi disa herë”, tha Prenda për Report Tv.

Kjo shtëpi, ndërtuar prej vitesh nuk ka njohur rikonstrukcion. Në ditët e dimrit dhe në kohë shiu, të qëndrosh brenda saj, është thuajse njësoj si të jesh në qiell të hapur. “Çfarë bie jashtë bie brenda, po përgatisim rrobat

kryesore që mos ti zërë shiu, se është hapur tavani, janë shtëpia të vjetra të para 100 vjetëve, por nuk kemi mundësi ti riparojmë se nuk kemi të ardhura, as punë asgjë nuk kemi”, shtoi 56 vjeçarja për Report Tv. Deri më sot, kjo grua, ka forcën për të ecur përpara duke shpresuar se gjërat do të ndryshojnë, ndonëse dyert i janë mbyllur.

Raporti për universitetin, ja shkeljet e Konit dhe Kules

Vazhdojnë hetimet ndaj rektorit dhe ish-rektorit të Universitetit të Tiranës. Report Tv zbardh raportin ku dalin abuzimet

Prokuroria e Krimeve të Rënda vazhdon hetimet ndaj dy profesorëve Mynyr Koni dhe Dhori Kule për dyshimet e abuzimeve me paratë publike dhe shpërdorimit të detyrës. Për të hedhur dritë mbi mënyrën e administrimit të rektoratit dhe univesiteteve akuzat ka administruar si provë dhe një raport audit të kryer nga ministria e arsimit në lidhje me veprimtarin e Universitetit të Tiranës.

Sipas këtij raporti që mban



Dhori Kule

firmën e Alqi Kushit, Mirela Bimos, Jeton Shehut, Iva Beliut dhe Bledar Biçokut, realizuar në periudhën 16 shkurt deri më 3 mars 2018, janë gjetur një sërë shkeljesh. Grupi i punës e nis konstatimin e tij me mungesën e një rregulloreje për funksionimin e Universitetit të Tiranës, rregullore e cila sipas tyre ende s'është miratuar. Një tjetër shkelje e konstatuar nga ky grup është dhe ajo e zbatimit të ligjit për sinjalizuesit. Ku sipas raportit rektorit ka nxjerr një urdhër që s'është në

kompetencën e tij por është e drejtë e senatëve akademike.

Ky raport nxjerr në pah dhe një skandal ku rezultoi se prej korrikut 2017 sistemi elektronik ku hidhen të dhënat e studentëve përfshi notat dhe mungesat nuk funksionin të paktën deri në mars 2018 kur është hartuar raporti kontrollit. Por ky sistem konstatojnë ekspertët e ministrisë aktualisht bllokohet pasi rektorit aktual i universitetit të Tiranës dhe kancelari kanë përplasje mes tyre dhe është ndërruar ëa e dhomës së serverit prej

15 shkurt 2017 dhe atë çelës e mban vetëm rektorit. Ky raport konstaton shkelje dhe në lidhjet e kontratave të punës ndërmjet institucioneve arsimore dhe pedagogëve, ndërsa ndalet edhe tek mos realizimi i të ardhurave që universiteti i Tiranës nuk ka kryer për buxhetin e vitit 2017.

Pak ditë pas lajmit për nisjen e hetimeve reagime pati dhe nga rektorit aktual Mynyr Koni dhe nga ish rektorit Dhori Kule, ndërsa pritet që pas pak ditësh ata të thirren nga prokurori për llogari të hetimit të nisur.




Mynyr Koni

VLORE

Prej dy vitesh janë ndërprerë punimet për rregullimin e portit

Një investim i nisur për rregullimin e portit të Vlorës, duke përfshirë thëllimin e kalatave, rregullimin e një moli, por edhe rikonstrukcionin e sheshit të këtij porti është pezulluar prej më shumë se një viti, kjo ka shkaktuar edhe probleme në ankorimin e trageteve. Investimi është vlera të konsiderueshme, por për këtë problem drejtorja e portit nuk ka marrë asnjë masë për të vijuar punimet. Investimi i qeverisë Italo-Shqiptare prej 15 milion euro për rehabilitimit e plotë të portit të Vlorës janë pezulluar prej më shumë se një vit. Punimet për

këtë port ishin parashikuar që të përfundonin në fund të vitit 2016, por punimet janë pezulluar duke shkaktuar mjaft probleme edhe në ankorimin e trageteve. Drejtori i portit të Vlorës Admir Malja nuk pranon të prononcohet, por fajin për këtë pezullim të punimeve drejtori ia adreson, firmës italiane “Piacentini”. Kjo firmë ka krijuar probleme jo vetëm në Vlorë, por kudo që kryen punime. Porti i Vlorës është konceptuar si pjesë e projektit “Lungomare”, që vazhdon nga pjesa e mbetur pezull, drejt Pyllit të Sodës. Pjesë e këtij projekti është



edhe ndërtimi i një porti jahtesh, si dhe ndërtimin e një sheshi kryesor mallrash dhe një terminali modern udhëtarësh. Drejtues të këtij porti janë pajtuar me pezullimin e punimeve nga ana e firmës, pasi edhe ata vet kanë pezulluar çdo lloj kërkesë ndaj instancave me të larta për të gjetur një zgjidhje.

PUNESIMI

Mercedezi prodhon pjesët në Librazhd, Balla: Është vetëm fillimi

Kohët e fundit zhvillimi i industrive automobilistike është zgjeruar edhe në Shqipëri. Kompanitë e prodhimit të makinave si; Mercedes-Benz, Ford dhe FIAT, e kanë shtrirë aktivitetin e tyre në disa qytete të Shqipërisë, e pikërisht në Librazhd. Ndërkohë, përmes një postimi në rrjetin social, Facebook, deputeti i Partisë Socialiste, Taulant Balla, na njehe me kompanitë, të cilat prodhojnë disa pajisje që përdoren për automjetet e kompanive të prodhimit të makinave Mercedes-Benz, Ford dhe FIAT. Kompanitë e prodhimit të makinave Mercedes-Benz, Ford dhe FIAT tashmë prodhojnë pjesë interiore të tyre në një fabrikë



në Librazhd. Ndoshta nuk do ta besoni, por është e vërtetë që pjesë me veshje lëkure si timoni, leva e marsheve apo leva e frenave të dorës të një makine Mercedes Benz, Ford apo FIAT që mund të blijnë pas

disa kohësh, është prodhuar në Shqipëri, në një fabrikë të vogël në Librazhd. Gjithashtu kompani të prodhimit të barkave detare si Castoldi apo kompani të prodhimit të traktorëve bujqësorë tashmë prodhojnë timonët e drejtimit të tyre në Librazhd. Është vetëm fillimi dhe janë punësuar dhjetra vajza dhe djem të rinj. Në muajt në vijim kompania SV MEGA, kontraktori shqiptar, synon ndërtimin në Librazhd të një fabrike më të madhe me standardet e emrave për të cilët punon, duke garantuar në të ardhmen një numër më të madh të punësuarish. PUNË PËR SHQIPËRINË QË DUAM”, tha Taulant Balla, deputeti i Partisë Socialiste.

Fadil Kepi: Pensioni i parakohshëm si përfitohet nga nënat me shumë fëmijë

Eksperti, çfarë kushtesh duhen për pensionet suplementare për ushtarakët e minatorët

Si çdo javë, në Report TV, në emisionin "Këndi i Ekspertit" nën drejtimin e gazetares Valbona Mhilli, eksperti për çështjet e pensioneve Fadil Kepi ka sqaruar qytetarët mbi problematikat e pensioneve. Duke marrë shtysë nga letra e një qytetareje profesor Kepi ka sqaruar çështjen e daljes në pension parakohe të nënave me shumë fëmijë. Po kështu eksperti ka sqaruar qytetarët që kanë telefonuar në redaksi mbi problemet për mungesë dokumentacioni, për kushtet për përfundimin e pensionit suplementar nga ish-ushtarakët si dhe për kushtet që duhet të plotësohen për të përfunduar pension pleqërie si minator.

Na shkruan një zonjë nga Vlora: "Në maj mbush moshën 55 vjeçe. Kam lindur gjashtë fëmijë. Sipas librezës së punës kam 29 vite pune të siguruar. Asistenca mbaroi. A më takon pensioni i plotë, si nënë me shumë fëmijë? Po i reduktuar?"

Të interesuarës nga Vlora, meqenëse ka lindur gjashtë fëmijë, dhe fatmirësisht i ka mirë me shëndet dhe mbi 8 vjeç, i lind e drejta që me dëshirë të dalë në pension të plotë në moshën 55 vjeçe. Por duhet të ketë 30 vite pune dhe të gjashtë fëmijët të jenë të moshës mbi 8 vjeç. Ajo, moshën 55 vjeçe e mbush këtë muaj, fëmijët i ka mbi 8 vjeç, por nuk ka 30 vjet punë. Atëherë duhet të bëjë sigurime vullnetare për një vit, pra për atë periudhë që nuk ka punuar. Asistenca i quhet vjetërsi pune. Unë i kam bërë llogaritë dhe bashkë me asistencën, zonjës i dalin 29 vite pune. Atëherë, duhet edhe një vit tjetër i siguruar që të përfitojë pension të plotë ditën që mbush 55 vjeçe. I leverdis që të sigurohet edhe një vit. Ajo pyet nëse mund të marrë pension të pjesshëm. Pensionin nënat me shumë fëmijë, nëse kanë 30 vjet punë e fitojnë në moshën 55 vjeçe. Ndryshe pastaj do të dalë në pension në moshën 60 vjeçe e 8 muaj, si të gjitha gratë e tjera. Pra, i duhen edhe 5 vjet e 8 muaj. Dhe me 29 vite punë që ka ajo, kur të plotësojë moshën 60 vjeçe e 8 muaj, nuk merr pension si nënë me shumë fëmijë, por si nënat e tjera me pak fëmijë dhe do t'i duhen 36 vjet e 8 muaj punë. Me 29 vite punë ajo do të marrë rreth 77%

të pensionit të plotë. Për nënat me shumë fëmijë, që dalin në pension në moshën 55 vjeçe, ky është avantazhi. Por nëse këto nëna kanë një vend pune të mirë, si p.sh. mësuese apo mjekë etj., qendra e punës nuk ka të drejtë ta heqë nga puna në moshën 55 vjeçe sepse nënave me shumë fëmijë u lind e drejta që të dalin në pension në këtë moshë, me dëshirë. Shpeshherë disa qendra pune, "për të hapur" vende pune i nxjerrin në pension. Jo, kjo bëhet me dëshirën e vetë gruas. Unë i sugjeroj zonjës që të shkojë që nesër te Sigurimet Shoqërore, të bëjë sigurime vullnetare edhe për një vit, se kjo është me leverdi për të.

Flas nga Tirana. Kam dalë në pension dhe jam 75 vjeç. Kam punuar 5 vjet si nënoficer. A më takon shtesë tani?

Ushtarakët që kanë punuar në Policinë e Shtetit, në Forcat e Armatosura, në Policinë e Burgjeve, në Forcat Zjarrfikëse, marrin, përveç pensionit të plotë të pleqërisë, edhe pension suplementar. Pensioni suplementar merret për aq vite sa ke punuar ush-

Sigurimeve Shoqërore të Tiranës, i cili pret qytetarët çdo ditë të mërkurë. Uroj ta gëzoni pensionin gjatë dhe me shëndet të mirë.

Na shkruan zonja Rajmonda Sula nga Tirana, por që tani banon në Gjermani: "Më 1 shtator 2018 mbush moshën 58 vjeçe. Në Shqipëri kam punuar 10 vjet e 6 muaj, e siguruar. Kur do të dal në pension. A mund të bëj sigurime vullnetare?"

Zonja ka punuar në Shqipëri 10 vjet e 6 muaj. Prej vitesh ajo banon në Gjermani. Edhe atje punon e siguruar. Në Shqipëri do të dalë në pension kur të plotësojë moshën 60 vjeçe e 10 muaj, pra më 1 korrik të vitit 2019. Afërsisht i duhen edhe 14 muaj. Për të marrë pension në Shqipëri asaj i duhen të paktën 15 vjet punë. Nuk i ka. Duhet të bëjë sigurime vullnetare për 4 vjet e 6 muaj. Në qoftë se nuk bën sigurime vullnetare ato 10 vjet e 6 muaj që ka punuar i shkojnë dëm. Sigurimet vullnetare mund t'ia paguajnë edhe të afërm këtu në Tiranë, ose kur të vijë vetë zakonisht gjatë verës.

Pra ajo duhet patjetër të arrijë minimumin e domosdoshëm për pension sepse pensionin e plotë për të cilin duhen 36 vjet e 6 muaj nuk e arrin dot. Por, ka një problem. Për të bërë sigurime vullnetare duhen plotësuar dy kushte: kushti i parë është që personi duhet të jetë mbi 18 vjeç dhe këtë kusht zonja e plotëson. Kushti i dytë është: personi duhet të ketë nënshpëtimin shqiptar ose dy nënshpëtimin. Mirëpo Gjermania nuk lejon me dy nënshpëtimin. Fillimisht zonja ka pasur nënshpëtimin shqiptar, kur ka shkuar në Gjermani. Më vonë ka marrë nënshpëtimin gjerman. Për periudhën që ka pasur nënshpëtimin shqiptar, ajo ka të drejtë të bëjë sigurimet vullnetare, pavarësisht se sa vite kanë kaluar. Sigurimet vullnetare në vendin tonë bëhen për të gjitha periudhat e pasiguruar, nga 1 tetori i vitit 1993 e në vazhdim, derisa të plotësojë moshën për pension. Pra duhet të gjejë atë hapësirë për 4 vjet e 6 muaj, që ka pasur nënshpëtimin shqiptar, dhe të bëjë sigurimet vullnetare. Tani ajo i plotëson kushtet për të marrë pension në Gjermani sepse ka nënshpëtimin gjerman dhe plotëson edhe minimumin e domosdoshëm, madje e ka tejkaluar. Kështu që



do të marrë dy pensione: pension sipas viteve të punës që ka punuar në Gjermani dhe pension në vendin tonë. Por nëse zonja i ka mundësitë financiare, të bëjë sigurime vullnetare për më shumë vite pune, aq më mirë për të sepse sa më shumë vite pune të siguruara, aq më i lartë del pensioni. Gjithmonë duke parë hapësirën deri kur ka marrë nënshpëtimin gjerman. Ka edhe një problem tjetër: nëse zonja nuk sigurohet për 4 vjet e 6 muaj, por e lë me 10 vjet e 6 muaj punë, aq sa ka punuar, nuk përfiton pension social as në moshën 70 vjeçe. Sepse në moshën 70 vjeçe, ajo duhet të plotësojë një kusht tjetër për të përfituar pensionin social: jo vetëm duhet të ketë nënshpëtimin shqiptar, por duhet që 5 vitet e fundit para plotësimin të moshës 70 vjeçe, të ketë banuar në Shqipëri. Por ajo banon në Gjermani, kështu që i humb e drejta për të marrë pension në moshën 70 vjeçe. Shpresoj që zonja të jetë duke na ndjekur. Por unë shpresoj që nëpërmjet rastit të saj, të sqarohet edhe shumë emigrantë të tjerë. Pse? Sepse po i afrohem verës. Në verë emigrantët vijnë me pushime, por në verë bëhen edhe shumë dasma. Kështu që unë u sugjeroj që të bëjnë një rrugë e tre punë, d.m.th. të bëjnë pushimet e tyre, të argëtohen nëpër dasma, por edhe të shkojnë tek Agjencitë e Sigurimeve Shoqërore dhe të interesohen për pensionet e tyre. Sigurimet vullnetare janë me leverdi, shuma është 5.184 lekë të rinj për një muaj.

Flas nga Kamza. Jam 64 vjeç. Kam punuar 19 vjet në minierën e Valiasit, në sipërfaqe. Këto vite nuk gjenden të shënuara. Gjendet vetëm viti i fundit i asistencës. Ç duhet të bëj unë?

Të gjithë minatorët e nëntokës që plotësojnë moshën 55 vjeç dhe kanë gjithsej 30 vjet punë të siguruar, ku vjetërsi pune quhet edhe periudha e asistencës, periudha e ushtrisë, vetësigurimet në bujqësi, sigurimet vullnetare, dhe nga këto 30 vjet, 12 vjet e 6 muaj kanë punuar nëntokë, të dokumentuara, dalin në pension të plotë 55 vjeç. Siç duket ju nuk i keni gjetur 12 vjet e 6 muaj nëntokë të siguruar. Agjencia e Sigurimeve Shoqërore duhet të japë një dokument zyrtar ku të deklarojë që në arkivin në Lundër nuk gjendet vërtetimi që


ju keni punuar nëntokë, atëherë ju mbetet vetëm një rrugë, ajo gjyqësore. Duhet që me dy dëshmitarë të bësh një proces gjyqësor dhe të vërtetosh ato vite që ke punuar. Në moshën 65 vjeç, pra në vitin 2019, ty të lind e drejta për të marrë pension edhe sikur të mos i kesh 12 vjet e 6 muaj nëntokë. Por mjafton të kesh 15 vjet e lart punë të siguruar në vendin tonë. Sqarime më të hollësishme, do të marrësh në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore në Kamëz, ku do shkosh bashkë me librezën e punës. Agjencia e Sigurimeve Shoqërore në Kamëz, kërkesën tuaj, ia dërgon Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë dhe kjo drejtori ia dërgon kërkesën Arkivit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në Lundër. Ke kohë edhe një vit që ta ndjekësh këtë problem. Mendoj se problemi yt do të zgjidhet.

Flas nga Athina. Kam punuar në minierë në Pogradec. Kam punuar 13 vjet nëntokë, 7 vjet si brigadier teknik dhe vitet e tjera punë të ndryshme nëntokë. Jam 55 vjeç e 6 muaj. Te Sigurimet Shoqërore në Pogradec më thanë që si brigadier teknik më duhet koeficient më shumë.

Unë i sugjeroj të interesuarit që përgjigjen nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore në Pogradec ta marrë me shkrim, me firmë dhe me vulë. Asnjë Agjenci e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri nuk ka të drejtën të lidhë pensione. Punonjësja e Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore normalisht duhet të vepronte kështu: të merrte librezën e punës së personit dhe një kërkesë dhe t'ia dërgonte Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Korçë. Sigurimet Shoqërore në Korçë kanë specialistë. Në të vërtetë, jo çdo person që punon në minierë quhet minator i nëntokës. Minator apo person që ka punuar nëntokë quhet ai person që ka punuar 8 orë nëntokë. Këta nuk kanë qenë të gjithë minatorë, por edhe elektrikistë, inxhinierë etj., të cilët kanë punuar nëntokë. Zotëria duhet të fillojë ta ndjekë çështjen nga e para. Fillimisht duhet t'i bëjë një ankesë me shkrim Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Korçë. Dhe përgjigjen duhet me doemos që ta marrësh me shkrim, me firmë e me vulë.



Simbolika e sheshit të Tiranës ndër vite, funksioni, arkitektuara dhe monumentet



► Detaj nga Sheshi Skënderbej

NGA **DR. ARJOLA PRIFTI**

Sheshi, në rrugën imagjinare të kujtesës, është vendosur gjithmonë në qendër të një sistemi kompleks dhe të ndërlikuar shenjash urbane, ku në të përmbledhen në të njëjtën kohë burimi dhe zgjidhja. Duke rimarrë konceptin antropologjiko-qendror sipas së cilës njeriu gjendet në qendër të botës dhe arkitektura shërben për të krijuar një hapësirë për të, e menduar sipas mizurave të tij është në gjendje të garantojë të jetuarit. Sheshi është një hapësirë e përfutur nga një zgjidhje e vazhdueshmërisë së të punuarit, një qendër force, e një poten-

cialiteti të pashprehur apo të shprehur në një nivel të ndryshëm, shpesh e përcaktuar dhe e karakterizuar nga një pjesëmarrje e veçantë arkitektonike e një rëndësie të caktuar (si kishë, monument, pallat mbretëror, muze, shatërvan etj). Një interpretim hapsinor i një koncepti universal, është grumbullimi, për të cilin çdo epokë dhe shoqëri kanë kontribuar, në kohë dhe periudha të ndryshme historike. Një reflektim i tillë mbi domethënien dhe mbi rolin e sheshit si sistem urban është shumë kuptimplotë në panoramën e vendeve dhe jo

vendeve bashkëkohore, e dominuar nga zgjedhja e shesheve si vendi i takimit dhe mbledhjeve sociale e shoqërore. Gjithashtu sheshi është një metaforë e zemrës, ose e qendrës së shenjtë nga të cilat rrezatojnë ndikimet shpirtërore, hapësira e përfunduar, parajsë në mesin e të cilës është vendosur Pema, simboli polar kozmik, e cila është rritja, ngjitja, imazhi dinamik i botës, emblema e jetës shpirtërore.

faqet 14-16

■ **Qendra e kryeqytetit/** Sheshi "Skënderbej" me 40 000 m², më i madhi i Shqipërisë

■ **Sheshet në histori/** Arkitekturat nga Agora Greke te forumi Romak e deri më sot




Kodiku i katërt në bibliotekën kastriotase me portretin origjinal të Skënderbeut

Në kemi pasqyrë Skënderbenë, i përqsasur me Shën Luisin e Francës". Me këtë thënie diamant të Faik Konicës te "Albania" e nisim shkrimin tonë për Heroin Kombëtar Gjergj Kastrioti në kërkim të pasqyrës së tij të vërtetë identitare dhe origjinale në bazë të dëshmimeve dhe veprave të artit që na kanë ardhur gjer më sot.

Nuk ka si të mos vëmë në dukje që në fillim se katër vjet pas Kuvendit dhe Lidhjes së Lezhës, emri i Skënderbeut ishte bërë tanimë i njohur në Europë për fitoret e korrura të shqiptarëve ndaj osmanëve...

NGA **FOTAG ANDREA**

faqe 18-20



Roli i gazetarit në demokraci

Nuk është një situatë e këndëshme të flitet për veten e, ndoshta, nuk do t'a kisha marrë atë mundim, nëse në këtë rast nuk do t'ishte e përshtatshme të sqaroja shkurtime isht arsyet që më detyruan të përdomja termin "demokraci", të huajtur nga një publicist e shkrimtar i shquar ballkanas i kohës sonë, Predrag Matvejević, në titullin e librit tim.

NGA **EUGJEN MERLIKA**

faqe 17

STUDIMI | QYTETI

NGA DR. ARJOLA PRIFTI

Sheshi, në rrugën imagjinare të kujtesës, është vendosur gjithmonë në qendër të një sistemi kompleks dhe të ndërlikuar shenjash urbane, ku në të përmblihen në të njëjtën kohë burimi dhe zgjidhja. Duke rimarrë konceptin antropologjiko-qendror sipas së cilës njeriu gjendet në qendër të botës dhe arkitektura shërben për të krijuar një hapësirë për të, e menduar sipas mizurave të tij është në gjendje të garantojë të jetuarit. Sheshi është një hapësirë e përfutur nga një zgjidhje e vazhdueshmërisë së të punuarit, një qendër force, e një potencialiteti të pashprehur apo të shprehur në një nivel të ndryshëm, shpesh e përcaktuar dhe e karakterizuar nga një pjesëmarrje e veçantë arkitektonike e një rëndësie të caktuar (si kishë, monument, pallat mbretëror, muze, shatërvan etj). Një interpretim hapsinor i një koncepti universal, është grumbullimi, për të cilin çdo epokë dhe shoqëri kanë kontribuar, në kohë dhe periudha të ndryshme historike. Një reflektim i tillë mbi domethënien dhe mbi rolin e sheshit si sistem urban është shumë kuptimplotë në panoramën e vendeve dhe jo vendeve bashkëkohore, e dominuar nga zgjedhja e shesheve si vendi i takimit dhe mbledhjeve sociale e shoqërore. Gjithashtu sheshi është një metaforë e zemrës, ose e qendrës së shenjtë nga të cilat rrezatojnë ndikimet shpirtërore, hapësira e përfunduar, parajsja në mesin e të cilës është vendosur Pema, simboli polar kozmik, e cila është rritja, ngjitja, imazhi dinamik i botës, emblema e jetës shpirtërore.

SHESHI DHE KUPTIMI I TIJ

Sheshi, në rrugën imagjinare të kujtesës, është vendosur gjithmonë në qendër të një sistemi kompleks dhe të ndërlikuar shenjash urbane, ku në të përmblihen në të njëjtën kohë burimi dhe zgjidhja. Qyteti është gjeneruar nga një vakum apo hapësirë e dedikuar dhe e përcaktuar, dhe kompleksiteti i saj shkrihet ose shpaloset në shesh, është pika e mbarimit dhe qendra e rrugës gjarpërore apo labirintike. Sheshi është një hapësirë e përfutur nga një zgjidhje e vazhdueshmërisë së të punuarit, një qendër force, e një potencialiteti të pashprehur apo të shprehur në një nivel të ndryshëm, shpesh e përcaktuar dhe e karakterizuar nga një pjesëmarrje e një objekti të veçantë arkitektonik të një rëndësie të caktuar (si kishë, monument, pallat mbretëror, muze, shatërvan etj). Ajo paraqet gjithashtu një shenjë të preksme të një fuqie e cila nuk mund të mos lërë gjurmë të dukshme. Ashtu si qyteti tokësor nuk është gjë tjetër përveçse pasqyrë e paqartë dhe e pasaktë që i referohet grimcave të dritës dhe të lavdisë së Qytetit Qiellor. Sheshi është një metaforë e zemrës, ose e qendrës së shenjtë nga të cilat rrezatojnë ndikimet shpirtërore, hapësira e përfunduar, parajsja në mesin e të cilës është vendosur Pema, simboli polar kozmik, e cila është rritja, ngjitja,



► Detaj nga Sheshi Skënderbej

Simbolika e sheshit të Tiranës ndër vite, funksioni, arkitektuara dhe monumentet

Qendra e kryeqytetit, Sheshi "Skënderbej" 40 000 m², më i madhi i Shqipërisë Sheshi ka pësuar ndryshimet e fundit në 2016-2017. U konceptua nga Mbreti Zog I në stilin arkitektonik neo-racionalist. U zgjerua në vitet '20-'30 nga Mbretëria e Italisë. Rimodelohet në periudhën komuniste sipas kërkesave të regjimit.

imazhi dinamik i botës, emblema e jetës shpirtërore.

Kjo mënyrë simbolike e të parit të sheshit është ajo që, edhe pse në mënyrë jo të vetëdijshme, ka ndikuar në strukturën dhe në arredimin që karakterizojnë në përgjithësi këto zona. Edhe Shatërvani është gjithashtu një element shumë simbolik, që përfaqëson jetën, burimin e rinisë dhe parimin shpirtëror të mësimdhënies. Tradicionalisht burimi ka lindur në këmbët e Pemës së Jetës, në Parajsën tokësore, dhe prej saj nisen katër lumenj që rrjedhin në katër drejtimet e hapësirës, dhe uji që përtërihet gjithmonë paraqet mocionin e pandërprerë, përjetës-

inë. Duket qartë marrëdhënia e ngushtë në mes të katër lumenjve dhe panelet e ndarjes të hapësirës urbane në qendër të së cilës sheshi duket si pikë qendrore, kërthizë, qendra e rrezatimit të forcave nga një pikëpamje e palëvizshme. Në të gjitha versionet, krijimi u zhvillua duke filluar nga një qendër, nga një pikë fillestare, nga e cila nisen katër lumenjtë në të katër pikat kardinale apo kyçe, duke dizenuar Kuarternarin e parë të zgjerimit krijues, kryqin e parë. Ajo është një rrjedhë energjish, potencialiteti, i cili përcakton gjurmët primitive të zgjerimit të hapësirës urbane në përputhje me skemat e përbashkëta dhe grumbullimet

më të vjetra të njerëzimit, madje një model mendor më parë se fizik. Sipas reflektimit teologjik procesi i krijimit material, duke pasur origjinën e saj në një qendër, parajsja tokësore, ka tendencë për t'u kthyer në këtë model primitiv që të shpengojë veten nga gabimet dhe të rifitojë gjendjen origjinale të hijeshisë.

Pra sheshi, qendra e krijimit dhe terreni i materializuar, reflektimi tokësor i asaj shpirtëror, është vendi në të cilin kanë bërë marrëveshje të gjitha rrugët e botës, destinacioni i pandërprerë i peligrinazhit të njerëzve në kërkim të parimit të pandryshueshmërisë, burim i së vërtetës dhe shpëtimit.

Brenda rrjetit të rrugëve dhe shtresave që përbëjnë planin territorial, sheshi përfaqëson hapësirën në të cilën shprehet jeta kolektive pra forma urbane në të cilën çdo shoqëri ka përfaqësuar vetveten. Sheshi për këtë arsye mund të përkufizohet si një trashëgimi kulturore e ndërmjetme, ndërmjet monumentit të vetëm dhe vazhdimësisë urbane, duke grumbulluar funksionet dhe qëndrimet publike kontradiktore me jetën private të ndërtesave dhe pallateve të banuara.

Sheshi me karakter zyrtar apo monumental, vendi i pushtetit dhe i paradave, por edhe hapësira ideale, sheshi ka qenë gjithmonë



Sheshi Skënderbej



Pazari i Ri i Tiranës

objekt i ndryshmeve kontraktore, sipas kuptimeve të ndryshme që i atribuohen atij. Për këto arsye sheshi është një pikë e rëndësishme reflektimi duke marrë parasysh dhe duke analizuar ndryshimet që ky objekt pëson në kohëra të ndryshme historike duke qenë i lidhur ngushtë me sjelljet dhe ndërveprimet e ndryshme të banorëve, gjatë shekujve.

Kur flasim për fjalën Shesh, menjëherë na vjen në mendje "Sheshi Skënderbej", i cili është sheshi qendror i Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Ky është sheshi më i madh i Shqipërisë me një sipërfaqe afërsisht 40 000 m². Sheshi mori këtë emër në vitin 1968 kur u vendos monumenti i Skënderbeut mbi kalë i skulptorit Odhise Paskali.

Sheshi e mori këtë emër në nderim të Heroit Kombëtar Shqiptar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe është vendi simbol jo vetëm i kryeqytetit por i të gjithë shqiptarëve, që me sipërfaqen e tij përfaqëson më së miri qendrën gjeografike dhe politike të Shqipërisë. Fokusi i këtij sheshi është përqendruar në statujën madhështore kushtuar heroit kombëtar, përball të cilit shtrihet mbi bazën e simetrive simbolike arkitektonike dhe urbanistike, ndërtesa me një arkitekturë racionaliste e Muzeut Historik Kombëtar.

Ky shesh u konceptua fillimisht në qendrën historike të Tiranës nga Mbreti Zog I në bazë të stilit arkitektonik neo-racionalist, ajo u zgjerua në vitet ndërmjet 1920-1930 nën diktaturën fashiste të Mbretërisë së Italisë. Më pas, në periudhën komuniste (1944-1990), u rimodelua sipas kërkesave të regjimit të atëhershëm. Ndryshimet e fundit në këtë shesh u bënë gjatë viteve 2016-2017. Aktualisht ky shesh sjell një impakt më ndërveprues me njeriun dhe bëhet simbol i jetës së përditshme të tij. Është vendi dhe hapësira shplohëse dhe gjithashtu pika e takimit për

qytetarët jo vetëm të Tiranës por të gjithë Shqipërisë.

Sheshi rrethohet sot nga Banka Kombëtare e Shqipërisë (1936), Muzeu Historik Kombëtar (1981), Hotel Tirana International (1979), Pallati i Kulturës (1960), Kulla e Sahatit (1821), Xhamia e Ethem Beut (1823), Bashkia e Tiranës (1920), Teatri Kombëtar i Fëmijëve (1920).

ARKITEKTURA DHE FUNKSIONI I SHESHIT. TEATRI I SKENËS SË PËRDITSHME.

Pazari i Ri i Tiranës mori jetë në vitin 1931 dhe në vitet që pasuan njohu vetëm rritje dhe zhvillim. Ai u krijua si nevojë e shtimit të aktivitetit tregtar i cili nuk mund të përballohej vetëm me Pazarin e Vjetër. Pas prishjes së Pazarit

është kthyer në një zonë të zhvillimit të biznesit për të ofruar një model të ri investimi dhe hapësire komunitare. Pazar i Ri është një hapësirë që funksionon në çdo orë, ku paradite fokusi më i madh është tek tregtimi i produkteve dhe pasdite tek çështjet e kulinarisë, për restorantet rreth e rrotull dhe zhvillimin e aktiviteteve artistike – kulturore si festa, panaire, etj. Tregjet tradicionale, e veçanërisht pazaret e vjetra, kanë përfaqësuar jo vetëm hapësirat urbane të shkëmbimit ekonomik, por edhe hapësirat urbane me intensitetin më të lartë të komunikimit shoqëror dhe kulturor.

Duke rimarrë konceptin antropologjiko-qendror sipas së cilës njeriu gjendet në qendër të botës dhe arkitektura shërben për të

vendi i takimit dhe mbledhjeve sociale e shoqërore. Procesi i bashkimit të formave dhe vëltimeve të një sheshi njihen si një elementet përbërës të hapësirave kolektive, duke mohuar monotoninë e një hapësire lineare në favor të një ndërprerjeje planesh dhe pikëvështrimesh.

Logjika kompozicionale duket e kuptueshme dhe perceptohet në sekuençën natyrale të hapësirave e bazuar në perceptimin e boshllëkut si hapësirë ndërveprimi. Secili prej këtyre elementeve të kujton format esenciale, dhe kërkimin e elementeve arkitektonikë si emblema të qytetit bashkëkohor.

Sa herë, duke ecur në një qytet të panjohur papritmas jemi ndalur atje, të tërhequr nga bukuria misterioze e një sheshi dhe nga

duket se është harruar nga historia e kohëve të fundit urbane, por që ne duhet të mësojmë përsëri në qoftë se duam të veprojmë në qytetet, si në ato moderne apo të konsoliduara qofshin ato. Do të përpiqemi atëherë të rekuperojmë, duke lexuar transformimet e gjurmëve dhe evolucionin social të qytetit, ai mister jetik që ka shmangur rënien dhe ka lejuar zhvillimin e shkencës urbane pra të arkitekturës.

Do të diskutohet rreth sheshin duke kërkuar idenë e saj paraprake, format e saj që janë trashëguar duke kaluar kufijtë gjeografike dhe kulturore, në një përpjekje për të identifikuar llojet dhe modelet që mund të shërbejnë si një udhëzues në prodhimin tonë bashkëkohor, të bindur se njohja e këtyre



Detaj nga Pazar i Ri i Tiranës



Detaj nga Pazar i Ri i Tiranës

të Vjetër në vitin 1959, Pazar i Ri mbeti për shumë kohë qendra e vetme, e madhe e tregtisë së mishit, peshkut, perimeve e frutave në Tiranë. Ky pazar ndodhet në atë zonë të Tiranës, që së bashku me lagjen e Mujos përfaqëson një nga zonat më të vjetra të qytetit. Edhe sot Pazar i Ri vazhdon të mbetet një nga tregjet më të mëdhenj për tregtimin e mishit, peshkut, perimeve e frutave në kryeqytet. Tashmë kjo zonë është ridimensionuar dhe

krijuar një hapësirë për të, e menduar sipas mizurave të tij është në gjendje të garantojë të jetuarit. Një interpretim hapsinor i një koncepti universal, është grumbullimi, për të cilin çdo epokë dhe shoqëri kanë kontribuar, në kohë dhe periudha të ndryshme historike. Një reflektim i tillë mbi domethënien dhe mbi rolin e sheshit si sistem urban është shumë kuptimplotë në panoramën e vendeve dhe jo vendeve bashkëkohore, e dominuar nga zgjedhja e shesheve si

arkitekturat e saj dhe pastaj, kemi vazhduar të ecim. Ky qytet atëherë deri diku i panjohur tashmë është bërë jashtëzakonisht i njohur, sikur gjurmët e tij të ishin rishfaqur nga thellësitë ku ato ishin vendosur. Dhe sa herë kujtimi i një udhëtimi, të ngulit në mendje disa vende të caktuara ku vetë jeta ka ndaluar dhe vazhdon të zhvillohet atje. Kujtimi i atyre vendeve ku, të huajt, janë ndërjerë tepër të mirëpritur, mishëron misterin e artit të lashtë të ndërtimit të qyteteve. Një art që

organizmave, i ngjarjeve, i sjelljeve mund të përkthehet, në termat e të sotmes, në përpunimin e ri dhe të mrekullueshëm të projektimit.

"Në secilin vend – shkruan Quatremère de Quincy në veprën e tij Dictionnaire Historique d'Architecture, publikuar në Paris në vitin 1832 – arti i të fabrikuarit rregullisht ka lindur nga një embrion që ka ekzistuar më parë...."

STUDIMI | QYTETI

vijon nga faqja 15

...Është shumë e rëndësishme të kuptohet se një ngjarje e mëparshme; asgjë në çdo lloj zhanri, nuk vjen nga asgjëja; por kjo nuk mund të mos zbatohet për të gjitha shpikjet e njerëzimit. Kështu ne shohim se të gjithë, pavarësisht nga ndryshimet e mëparshme, kanë ruajtur gjithmonë të qartë, gjithmonë të dukshme në ndjenjën dhe arsyetimin e parimit të tyre fillestar. Sheshi është ndërtuar nëpërmjet shtresave të ngadalta apo është realizuar nga e para në qytetet e reja, është hapësira e privilegjuar, vendi i takimit dhe i shkëmbimit, ku kultura dhe historia, simbolet dhe traditat janë ringjallur çdo ditë në një formë harmonike thelbin e të cilit është e mundur ta hasim përmes idesë së Aristotelit të sigurisë dhe lumturisë që një qytet duhet të jetë në gjendje të ofrojë banorëve të saj. Indikacionet e planeve rregulluese, modelet matematikore, respektimi i përpiktë ndaj diktatit të normativave të planifikimit urbanistik, nuk janë në gjendje për të interpretuar harmoninë e vendeve, as të ofrojnë në aspektin e cilësisë, një përgjigje konkrete ndaj kërkesës reale për hapësirë të jetesës, funksionale dhe të bukur.

Ne do të kujtojmë, si një premisë të detyrueshme, se ideja kryesore e sheshit është në të qenurit të saj si një hapësirë e mbyllur, e përcaktuar, e kufizuar. Këto cilësi kërkojnë marrëdhënie të ngushta dhe të detyrueshme dimensionale, për të mos humbur sensin e unitetit, të harmonisë, të identitetit, të përkatësisë. Sheshet tradicionale duken, të mbrojtura dhe të izoluar, të rrethuara nga ndërtesa të rëndësishme, perimetrike nga arkadat të cilat lejojnë një strehë hije verore dhe mbrojtje nga era e dimrit. Janë vendi në të cilën zhvillohet përfaqësimi i komunitetit dhe i fuqisë qytetare. Sheshet janë teatro të hapura, të pandërprera, të konceptuara për të akomoduar turmën e festave, të tregjeve, të festimeve fetare. Sheshi është vendi ku publiku dhe privati, kolektiviteti dhe individualja priren të ndërtojnë një hapësirë jo fort të veçantë. Rezultati është një shumëllojshmëri funksionesh, sinkronike dhe diakronike, e mundur vetëm në sajë të fleksibilitetit të skajshëm të vendit, i cili në të thekson karakterin e tij ambivalent të hapësirës bosh dhe në të njëjtën kohë të plotë, të jashtme dhe të brendshme. Prandaj, shpesh kanë pësuar gërshetime disa linja të shkurtra, që kanë sjellur ndryshime në pozicionin dhe rolin e sheshit në lidhje me pëlhurën urbane dhe karakteristikat e tij tipologjike dhe morfologjike, aftësija për tu lidhur me peizazhin natyror dhe artificial, konfigurimi hapësinor i sheshit dhe elementët përbërës të tij kanë pësuar ndryshime në kohë dhe në kultura të ndryshme të cilat kanë reflektuar në të.

SHESHET GJATË EPOKAVE TË NDRYSHME HISTORIKE

Duke filluar që nga Antikiteti, nga agora greke, nga Forumi Romak, madje edhe më herët, nga oborret e pallateve të Kretës ose të Mikenasve, deri në Mesjetë e më pas në periudhën e Rilindjes



Sheshi Nënë Tereza



Sheshi Adem Jashari

Sheshet në epoka të ndryshme nga Agora Greke te Forumi Romak e deri më sot

Kujtimi i atyre vendeve ku, të huajt, janë ndjerë tepër të mirëpritur, mishëron misterin e artit të lashtë të ndërtimit të qyteteve.

Europiane dhe Barokut, sheshi ka ruajtur, megjithëse duke ndryshuar në modelet dhe sistemet e ndryshme, karakteristikën e tij kryesore si vendi i përqendrimit të fortë kulturor dhe shoqëror. Nuk mund të mendojmë si diçka të forcuar idenë se figura hapësinore e sheshit vjen si rrjedhojë e Forumit Romak në Antikitet. Nga vetë leximi etimologjik që të jep idenë e sheshit: Forumi i ka rrënjët në fjalën latine Foris që shprehte thjesht vendin e jashtëm, për të përcaktuar hapësirën kuadrante përpara varrit, e më pas për të përcaktuar hapësirën e lirë përpara shtëpisë dhe për të kaluar më pas në një shesh katror brenda një lagjeje të banuar të përdorur për kuvendet ose për tregjet e ndryshme. Arketipi i sheshit është pra e gjurmueshme në hapësirë në frontin dhe vendin e varrimit. Zhvillimi i ceremonisë mortore apo riteve të ndryshme dhe i kulte

festive do t'i japë këtij vendi një shenjtëri të veçantë, që do e bëjnë atë një simbol, vend mbi vendet.

Forum i ka rrënjët në fjalën latine Foris që shprehte thjesht vendin e jashtëm, për të përcaktuar hapësirën kuadrante përpara varrit, e më pas për të përcaktuar hapësirën e lirë përpara shtëpisë dhe për të kaluar më pas në një shesh katror brenda një lagjeje të banuar të përdorur për kuvendet ose për tregjet e ndryshme. Arketipi i sheshit është pra e gjurmueshme në hapësirë në frontin dhe vendin e varrimit. Zhvillimi i ceremonisë mortore apo riteve të ndryshme dhe i kulte

Ndjenja kolektive e hapësirës

publike do të kalojë nëpër shekuj si një lloj trashëgimie gjenetike, deri në ndërtimin e shesheve mesjetare. Gjatë Rilindjes Europiane sheshi bëhet instrumenti nëpërmjet të cilit përcillej dhe diskutohet mbi reformat politike, sociale dhe urbane. Ndryshe nga sheshet Mesjetare, sheshet e periudhës së Rilindjes Europiane, madje edhe ato të periudhës së Barokut, kthehen në një vend simbolik, një figurë retorike, një mjet për festimin e miteve, riteve dhe fuqisë politike.

"Duhet të kihet parasysh -

shkruan Leon Battista Alberti në veprën e tij De Re Aedificatoria - se një qytet nuk është i destinuar vetëm për përdorim rezidencial, por duhet të jetë i tillë që në të, të jenë të rezervuara hapësira dhe ambiente shumë të këndshme si për funksionet qytetare dhe për orët e kohës së lirë në shesh, në karrocë, në kopshte, apo në shëtitje". Qenia e njeriut është në qendër të interesit të Albertit dhe rrjedhimisht shkalla humane është ajo që rregullon marrëdhëniet proporcionale të sheshit ideal. Sheshi si një hapësirë plot me efekte, me shumë pikëvështrime prespektive, në gjendje për të inkurajuar takime, për të sugjeruar marrëdhënie, për të mbështetur çdo të papritur. Në ditët e sotme sheshi është vazhdimisht pjesë e debateve urbanistike e arkitektonike dhe kjo bënë që të jetë shpesh pjesë e rikualifikimeve të ndryshme urbane.

BIBLIOGRAFIA

Art & Trashëgimi, nr. 4, Dossier Tirana, Rikthimi i Muzave, maj 2012.
 C. Salaris, L'immaginario aereo nella letteratura futurista, in Aereo e Pittura, a cura di B. Mantura, P. Rosazza-Ferraris, L. Velani, Napoli, 1989.
 Emin Riza. Historia e arkitekturës shqiptare nga fillimet deri 1912. Tiranë, 1987.
 Giuliano Gresleri, Massaretti, Pier Giorgio, Zagnoni, Stefano. Architettura italiana d'oltremare 1870-1940. (1993) Venezia: Marsilio, 1993.
 G. Gresleri, La via dell'est: da Tirana a Lubiana, in Architettura italiana d'oltremare 1870-1940, a c. di G. Gresleri, P.G. Massaretti, S. Zagnoni, Venezia, Marsilio Editori, 1993, pp. 323-331.
 Laura Bertolaccini, Architettura e funzione della piazza. Il teatro della scena quotidiana, in: Costruire in Laterizio, n. 44, Roma, marzo-aprile 1995.
 L. Billeri, Bosio e i piani urbanistici per le città dell'Albania, in Gherardo Bosio. Architetto

fiorentino, 1903-1941.
 L'amicizia tra Italia e Albania: passato, presente, futuro. (2006)
 La presenza italiana in Albania nella prima metà del XX secolo. Complesso di Vicolo Valdina, Roma 21-26 novembre 2006.
 M. Tafuri, Architettura del Umanesimo, Bari, 1969
 Maria Adriana Giusti. Albania, Architettura e Città 1925-1943. (2006) Finito di stampare nella tipografia Bandecchi & Vivaldi, Pontedera per conto di artout - Maschietto Editore, Firenze Dicembre 2006.
 Maria De Santis, Giuseppe Terragni. Casa del Fascio, Como, 1932-36, in Costruire in laterizio. Grandi Maestri. n. 117, maggio-giugno 2007. Massimo Locci, Nuova Banca di Albania Memoria e Innovazione. Concorso per il restauro e l'ampliamento della banca central a Tirana.
 Paolo Portoghesi, I grandi architetti del Novecento. Roma, Neeton & Compton Editori, 1998.

Paolo Nicoloso, Mussolini Architetto. Torino, Einaudi, 2008. K. Miho, I. Sukaj, P. Thomo, V. Bushati.
 Historia e arkitekturës në Shqipëri (1912-1944). (1988) Shtëpia Botuese e Librit Universitar. Tiranë, 1988.
 Rivista internazionale di storia urbana e territoriale, Direttore responsabile Enrico Guidoni. Storia della Città. Rivista trimestrale N. 54-55-56 (anno quindicesimo, II-III-IV). Le piazze. Lo spazio pubblico dal Medioevo all'età contemporanea, Casa editrice Electa, Milano, aprile-dicembre 1990.
 Sculture di Antonio Maraini dal 1908 al 1942. (1944) Album realizzato dall'artista nel 1942; il memoriale dell'artista, radatto nel Settembre 1944.
 Shkodra, Zija. Esnafet shqiptare (shek. XV-XX). Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 1973.
 The building of the bank of Albania. Brochure. Tirana 2003.

Roli i gazetarisë në demokracinë

NGA **EUGJEN MERLIKA**

Nuk është një situatë e këndshme të flitet për veten e, ndoshta, nuk do t'a kisha marrë atë mundim, nëse në këtë rast nuk do t'ishte e përshatshme të sqaroja shkurtimisht arsyet që më detyruan të përdorja termin "demokracinë", të huajtur nga një publicist e shkrimtar i shquar ballkanas i kohës sonë, Predrag Matvejević, në titullin e librit tim. Po e nis këtë përsiatje të shkurtër me një fjali të një filozofi dhe ekonomisti, ndër më të njohurit e mendimit ekonomik të shekullit XIX, anglezit John Stuart Mill, që më 1837, në moshën 31-vjeçare shprehej:

"Dëgjohet gjithandej tani se gazetaria është për Evropën bashkëkohore ajo që ishte oratoria politike për Athinën dhe për Romën, e që për t'u bërë ajo që nevojitet, duhet të përpunohet nga i njëjti lloj njerëzish". Filozofi anglez, nëpërmjet krahasimit të tij me botën e lashtë të kulturës greko-romake, arit të gazetarisë, jo vetëm që i jep një vlerësim madhor në ecurinë e shoqërisë, por e ngarkon me detyra që e venë atë në ballin e jetës shtetërore e kulturore të çfarëdo kombi, njësoj si oratorët e lashtësisë që ishin në gjendje të ndikonin mendimin dhe veprimin e tubimeve të qytetarëve të Athinës apo Romës, të cilët mbeten, ende sot, të paarrishëm në shkallën e nivelit kulturor të masës në përgjithësi.

Kjo fuqi e madhe që merr bota e medias në kohën tonë, e tejzmadhuar në mjetet e saj të panurmura, gjithmonë simbas Millit, është e kushtëzuar nga niveli cilësor i atyre që e ushtrojnë. Pa mëtuar që të kemi personalitete të gazetarisë në nivele të Eskinit, Demostenit apo Ciceronit, funksionimi i gazetarisë, si fuqi e katër e shteteve, mund të jetë e frutëshme nëse ata që e ushtrojnë janë në lartësinë e detyrës së tyre. Ajo detyrë kërkon veç përgatitjes kulturore edhe cilësi etribute të tjera të domosdoshme si aftësia për të vëzhguar e kapur të qenësishmen, mungesa e paragjytimeve në paraqitjen e gjykimin e fakteve, ndershmëria intelektuale, guximi vetiak e qytetar, prirja për të pohuar të vërtetën e, mbi të gjitha, pavarësia e plotë nga pushtetet e tjerë, politike apo ekonomike.

Mbas këtij parashtrimi të shkurtër të funksionit e rolit të botës mediatike në nivel planetar, po kthehem në librin tim: "Demokracia shqiptare në vështrimin e një të mërguari". Është një përmbledhje shkrimesh të një periudhe relativisht të gjatë, 2004 - 2017, që pasqyrojnë mendimet e përsiatjet vetiake rreth jetës politike, shoqërore, ekonomike kulturore të Shqipërisë të cilën, edhe se larg fizikisht jam munduar t'a ndjek me të njëjtin qëndrim që do të kisha mbajtur, po të jetoja aty. Si përfundim i bashkëjetesës shpirtërore e mendore me Shqipërinë e viteve të pas komunizmit, del ky vëllim, i treti i radhës, mbas "Përsiatjes" dhe "Elegji për brezin tim", e që mund të pasohet edhe nga dy të tjerë, nëse do të gjindet mundësia e botimit të tyre.

Si të gjithë ata shqiptarë që dolën nga një përmdekje 45 vjeçare e regjimit komunist, edhe un shpresova e mendova se ndryshimi i sistemit shoqëror, nga një diktaturë e hekurt në një demokraci, sado e brishtë që të ishte, përbente një kthesë të madhe, historike, në planin e përgjithshëm kombëtar e natë vetiak e familjar. Në të parin ndryshimet, edhe se epokale në sajë të shëmbjes së komunizmit si një sistem shtypës në gjithë pjesën lindore të Evropës, nuk patën ritmet e pritëshme, duke u luatur mes "një bote që nuk donte të vdiste e një tjetre e pafuqishme të lindëte". Në planin e dytë, atë familiar e vetiak, e vetmja mënyrë për t'u larguar nga Grabiani i Lushnjes, vendi i internimit të familjes në dhjetëvjeçarit e fundit, që largimi për në Itali, Vendi i lindjes së nënës sime. Aty filloi një tjetër jetë vështirësishe e pune të lodhëshme, por me kënaqësinë për të parë si shpërblim mbas shumë viteve tre bijtë e bijat të diplomuar e të sistemuar me punë.



Nisa të shkruaj që herët, kur m'u dha mundësia e botimit të artikujve. Këtu sot, me rastin e paraqitjes së këtij libri, po përfitoj për të falënderuar nga zemra redaksitë e gazetave "Sindikalisti", "Liria", "Republika", "55", "Bota shqiptare" (Romë), "Gazeta shqiptare", në shtojcën "Milosao", "Tema", "Shekulli", "Illyria" e "Dielli" në Nju Jork, "Standart", "Shqiptari i Italisë", "Metropol", "Shqiptarja.com", e deri tek "Mapo", e përditëshmjat në të cilën kam botuar shkrimet e mija prej dhjetë vitesh.

Ideja kryesore që përshkon ata shkrime është një dozë e fortë zhgënjimi, larg objektivave të pritjes që ushqenim, me mendimin e përfytyresën tonë në fillimin e viteve 90. Me kalimin e viteve ato shpresa avulluan si vesa në diell, sidomos për ata që kishin qënë viktimat e së gjatës e mizores "luftë e klasave". Demokracia e ëndëruar, me kalimin e kohës, mori trajtën e një sistemi partitokratik, që ndërronte ngjyrat së jashtëmi por që funksiononte me të njëjtat ligje, të shkruara e të pashkuara, në brendësi të saj. Duke u munduar të paraqes e të trajtoj në shkrimet e mija argumentet më në dukje të ecurisë së shoqërisë e të shtetit, rashë në përsëritje të temave, sepse problemet përsëriteshin herë mbas here, pa gjetur rrugën e zgjidhjes. Sistemi bëri hapa të ngadalshëm në ecjen drejt modelit të shoqërive Perëndimore, por vrapoi me revan drejt objektivave të pasurimit të klasës drejtuese, një dukuri që thellonte gjithënjë e më shumë pabarazinë ndërmjet shtresave të ndryshme të popullsisë. Paligjshmëria, e kthyer në sistem pasurimi të një pakice që kishte në dorë levat e drejtimit, kushtëzonte edhe strukturën mbajtëse të godinës së Shtetit, që mbyllej si iriqi, duke kundërshtuar çdo prirje ripërtëritje të klasës së tij drejtuese. Kështu, edhe ajo pak demokraci e viteve të para u kthye në një sistem hibrid, të ndërthurur ndërmjet shkërbimit të përvogës së botës Perëndimore e jehonës së mendësisë autoritare të gjysmë shekullit komunist. Mungesa e një force politike jashtë korizës së trashëgimisë komuniste, të tillë që të paraqiste një mundësi tjetër ndaj dypolarësisë Pd-Ps, që të kishte në kodin e saj gjenetik kombin e bashkuar në përparimin e shpejtë të tij, larg metodave e mjeteve të neosocializmit të korruptuar, u bë shkas që të ngurtësohej, deri në ngrirje, jeta politike shqiptare. Në këtë mënyrë demokracia mori trajtat e një sistemi të mangët e të prirur nga një farë autoritarizmi, të përfaqësuar nga t'ashtuquajturat figura karizmatike, gjëndje që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Termi "demokracinë" mendoj se i shkon më për shtat së vërtetës jetësore të Vendi tonë. A nuk është tipar i demokracisë

qenësia e një klase politike, në të cilën janë të pranishëm elementë të krimit në të gjitha format e veta e që, në eksponentët e saj kryesorë, e kanë kthyer politikën në profesion, në vend që të ishte një mision në shërbim të çështjes së madhe të Atdheut? A mund të quhet demokraci një sistem politik, në të cilin votat dhe rezultatet e tyre tjetërsohen në dobi t'atyre që qeverisin apo janë në gjendje t'i blejnë ato? A mund të quhet demokratik një Vendi në të cilin njihet vetëm formalisht pavarësia e pushteteve dhe institucioneve jo politike, mbasi gjithshka përgëndrohet në duart e atyre që "fitojnë" zgjedhjet e tjetërsuara? farë emri mund t'i vemë një shteti që, në çdo ndërrim pushteti qëndror, do të zëvendësojë të gjithë zyrtarët e të gjithë niveleve e profileve, duke bërë të jetojnë në ankthin e mbi-jetesës mijra njerëz?

A nuk është demokracinë ajo që vazhdon të mbajë kujtesën historike rob të mendësive të diktaturës, që nuk e dënon atë seriozisht, madje dekoron e merr në mbrojtje edhe autorët e krimeve të komunizmit? farë shteti demokratik është ai që, ende mbas gati tre dhjetëvjeçarësh, nuk arrin të sendërtojë premtimet e vendimet e tij për dëmshpërblimet e ish të dënuarve politikë, por i "ngrin" ata simbas dëshirës së ndonjë ministri apo kryeministri? A nuk është demokracinë një sistem shoqëror, në të cilin mbizotëron korrupsioni dhe mungesa e ligjëshmërisë deri në nivelet më të larta të Shtetit, duke përcaktuar pasurime maramendëse të paligjëruara, ndërsa u mohohet, në njëqind mënyra, pronarëve të ligjshëm e drejta e pronës së trashëguar? A është tregues demokracie fakti që drejtësia, gjatë gjithë këtyre viteve të shpërdorimit të pushtetit, në format më të ndryshme, nuk ka patur guximin dhe forcën të ndërhyjë, qoftë edhe një herë të vetme, kundër politikanëve? Si mund të konceptohet një demokraci që, prej më shumë se një të katër shekulli, nuk vendos të bëjë pjesëmarrës në procesin zgjedhor të Vendi të saj qindra mijra qytetarë të saj, të shpërndarë në të katër anët e botës?

Demokracia e ka kthyer Shqipërinë në një shtet pa asnjë strategji të dobishme ekonomike, e cila duhet të vlerësojë e nxisë punën e përditëshme të punonjësve në degët e ndryshme të ekonomisë, kryesisht të bujqësisë. Në gjithë këta vite të pas komunizmit, me përjashtim të ndërtimeve, edhe ata shpesh pa kriteret e duhur, ekonomia nuk ka pasur një strategji në përpunje me mundësitë potenciale të Vendi.

Këta e të tjerë argumenta janë temat e shkrimeve të këtij vëllimi, që pret gjykimin e lexuesvet, ashtu sikurse ka ndodhur kur janë botuar në organet e ndryshme të shtypit të shkruar apo online. Jam munduar të ruaj gjithmonë pavarësinë e mendimit e të opinionit, të mos kushtëzohem në bindjet e mija dhe duhet të pranoj se redaktorët e shkrimeve të mija në gazetë e ndryshme nuk kanë kërkuar asnjëherë të ndërhyjnë për të ndryshuar ndonjë frazë e për këtë u jam shumë mirënjohës. Pavarësia e mendimit, të cilën Anatole France e quante me të drejtë "aristokracia më fisnike", përjashton njëjtësimin me mendimin zyrtar në çdo rast, i cili e kthen gazetarin në një zëdhënës të paemëruar. Por ajo nuk duhet të bjerë ndesh me objektivitetin në gjykimin e veprimeve e dukurive, të cilët merren në shqyrtim.

Objektiviteti, paanësia janë ana tjetër e medaljes së domosdoshmërisë së suksesit e jetëgjatësisë të kujtdo që vendos t'i shërbejë tempullit të publicistikës, mbasi mashtrimi i ndërgjegjshëm do të ishte mëkati origjinal i gazetarisë. Në detyrën tepër të brishtë të mjetit kryesor të formimit të opinionit publik, është detyrë morale e profesionale e jona të shohim në çdo dukuri të jetës së Vendi tonë dritat dhe hijet e të kemi ndershmërinë t'i paraqesim ashtu si janë, pavarësisht nga kush i sendëron. Është gjithashtu detyrë e jona të mbajmë qëndrim me fjalën tonë kundrejt së keqes e të lëvojmë të mirën, atë që shkon në dobi të interesave të Atdheut, të Kombit, të shoqërisë, të përparimit, të s'ardhmes së Shqipërisë.

Fjala e mbajtur në promovimin e librit të tij "Demokracia shqiptare në vështrimin e një të mërguari"

TERMI
"demokracinë"
mendoj se i shkon
më për shtat së
vërtetës jetësore
të Vendi tonë. A
nuk është tipar
i demokracisë
qenësia e një klase
politike, në të cilën
janë të pranishëm
elementë të krimit
në të gjitha format
e veta e që, në
eksponentët e saj
kryesorë, e kanë
kthyer politikën
në profesion, në
vend që të ishte një
mision në shërbim
të çështjes së
madhe të Atdheut

STUDIME | KËRKIME

NGA FOTAG ANDREA

Ne kemi pasqyrë Skënderbenë, i përqsasur me Shën Luisin e Francës". Me këtë thënie diamant të Faik Konicës të "Albania" e nisim shkrimin tonë për Heroin Kombëtar Gjergj Kastrioti në kërkim të pasqyrës së tij të vërtetë identitare dhe origjinale në bazë të dëshmive dhe veprave të artit që na kanë ardhur gjer më sot.

Nuk ka si të mos vëmë në dukje që në fillim se katër vjet pas Kuvendit dhe Lidhjes së Lezhës, emri i Skënderbeut ishte bërë tanimë i njohur në Europë për fitoret e korrura të shqiptarëve ndaj osmanëve, që prej betejës së Torviollit (v. 1444) deri në qëndresën e Sfetigradit më 1448. Fakti historik është i tillë që sipas dëshmisë në "Notice historique sur la Maison de Saint-Mauris" një kështjellë në Savoje quhej "Fort de Scanderberg" (Fortesa e Skënderbeut) ose "Tour de Scanderberg" (Kulla e Skënderbeut). Olivier de la Marche, historian, diplomat, kapiten e kronikan i kohës, e përmend këtë fortifikatë më 1448, në kulmin e luftërave civile në Francë, kur Filip i Mirë (Philippe le Bon) – që do t'i dërgonte Skënderbeut ambasadorë pas rrethimit të parë e të dytë të Krujës – ndërmerre luftërat e tij në Franschë Kontenë e Burgonjës.

Pikërisht, kësaj periudhe, viteve 1448-1451 u referohet At Vinçens Malaj kur i njuh Antonio Pisano-s (Pisanello, 1395-1455) – mbi bazën e një hipoteze të parashtruar nga Leonardo de Martino da Greci – autorësinë e gravurimit të medaljonit me portretin ndoshta më të hershëm të Skënderbeut, që ruhet në Zagreb, pothuaj i ngjashëm me atë që ruhet në muzeun numizmatik të Berlinit (foto.1, 2, 3).

Para se të shohim rrethanat se si mund të ketë ndodhur realizimi i këtij/këtyre portreteve, le të themi në parantezë se përgjithësisht, në periudhën e Rilindjes italiane, çdo lloj veprë arti, e sidomos gravurimet dhe derdhjet e medaljoneve apo miniaturat e ndriçuara (enluminuret) në kodikë bëheshin tek artistët me porosi të veçantë: për të nderuar figurën historike që ato pasqyronin apo bëmat e këtij të fundit. Këto vepra artistike shërbenin kështu si dhurata të çmuara për të vlerësuar protagonistin kryesor, princ, mbret, dozh, funksionar, fisnik apo aleat, dhe jepeshin ose me ceremoni pritjeje, ose pasandaj shoqëronin kredencialet apo ndihmat materiale e financiare që dërgoheshin.

Në rastin konkret, nuk mund të përjashtohet hipoteza se dy medaljonet e para me portretin e Skënderbeut mund të jenë porositur nga Alfonsi i Aragonës te Pisanello, i cili në vitet e fundit të jetës, me një përvojë të shkëlqyer si piktor, medaljon-punues dhe miniaturist kodikësh, ndodhej pikërisht në Napoli më 1448-1451, periudha kur pas Traktatit të Paqes



Foto 1



Foto 2



Foto 3

Kodiku i katërt në bibliotekën kastriotase me portretin origjinal të Skënderbeut

Dy medaljonet e para me portretin e Skënderbeut mund të jenë porositur nga Alfonsi i Aragonës te Pisanello, i cili në vitet e fundit të jetës, me një përvojë të shkëlqyer si piktor, medaljon-punues dhe miniaturist kodikësh, ndodhej pikërisht në Napoli më 1448-1451, periudha kur pas Traktatit të Paqes me Venedikun (v.1448), Skënderbeu do arrinte fitoren historike ndaj turqve pas rrethimit të parë të Krujës...

me Venedikun (v.1448), Skënderbeu do arrinte fitoren historike ndaj turqve pas rrethimit të parë të Krujës (v. 1450).

Kohët e fundit, prof. Lutfi Alia, mbështetur tek studiuesi i njohur venecian Piero Voltolina, i bën një prezantim dhe trajtim shkencor tre medaljoneve me portretin e Skënderbeut që ndodhen në

katalogun voluminoz të Voltolina-s "Storia della Repubblica di Venezia attraverso le medaglie" (Milano, 1988). Bëhet fjalë për të njëjtat medaljone të derdhura, por studiuesi venecian e shtyn me një dhjetëvjeçar datën e prodhimit të tyre, realizuar, sipas tij, më 1463 në Venecie dhe më 1465 në Romë. Prof. Alia, duke iu referuar edhe

studiuesit Frederick Kenner (Vjenë 1898), është i mendimit se gravurimi i portretit të Skënderbeut (me autor anonim, në këtë rast), duhet të jetë bërë mbi bazën e skicimeve të G. Bellini-t më 1461, konkretisht kur Skënderbeu ishte i ftuar nga Papa Piu II në dasmën e Antonio Piccolominit, ose pastaj më 1463, kur Gjergj Kastrioti,

thekson ai, "vizitoi Venecian për të marrë pjesë në ceremoninë e shpalljes" Qytetar Nderi i Venetos".

Po prapë, se ku, kur dhe në ç'rrethana Bellini e ka skicuar Skënderbeun, në Napoli, Romë, Venedik apo Lagunova, kjo është një çështje që mbetet e hapur për hulumtim e studim të do-



Foto 12



Foto 13





Foto 14



Karaxha e L. Alia, të tërë janë në një zë kur pohojnë se portreti më i hershëm i Skënderbeut duhet të jetë realizuar nga Bellini (1429-1507) "d'après nature", mbi bazë skicimesh (sot të humbur) gjatë vizitës/vizitave të Kastriotit të Madh në Itali. Pra, modeli, lënda e parë e gjallë, ka qenë e pranishme, para syve dhe penelit të Bellini-t. Mirëpo, nuk përjashtohet mundësia që Heroi të jetë skicuar më parë edhe nga Bellini Ati (Jacopo).

Nga ana tjetër, mbetet e hapur për dokumentim shkencor edhe çështja nëse janë apo nuk janë të viteve 1449-1451 medaljonet e para që i njihen Pisanello-s. Sepse me të drejtë mund të shtrojmë pyetjen: përderisa gjer më sot nuk është dokumentuar që Skënderbeu të ketë qenë në këto vite në Itali, mbi çfarë baze modeli janë realizuar ai/ato portrete? Vërtet, nuk përjashtohet mundësia që të jenë bërë skicime të portretit të Skënderbeut edhe gjatë kësaj periudhe, brenda vendit apo në Raguzë e gjetkë, dhe më pas, këto skicime të jenë dërguar në Itali (gjatë vajtje-ardhjeve të ambasadorëve) për të përfunduar te Pisanello si porosi "nga lart" (nga kushdo që financonte) për të përgatitur dhuratën e veçantë, në rastin konkret medaljonet. Për më tepër që gjesti dhurues merr kuptim të madh gjatë kësaj periudhe, kur Gjergj Kastrioti njihet tashmë si "Zot i Arbrit" dhe bashkëpunonte suksesshëm me Vatikanin, Janosh Huniadin dhe Alfonsoin e Aragonës, kur kishte prapsur mbi njëzet sulme osmane dhe Kruja me qytetet e tjera të Arbërisë u bënë ballë rrethimeve të njëpasnjëshme, dhe sidomos kur ishte nënshkruar Traktati i Gaetës (mars 1451). Mbi të gjitha, pikërisht gjatë këtyre viteve datojnë edhe dy kodikët e famshëm me emblemen kastriotase që kanë qenë drejtpërdrejt në zotërim të Kastriotit të Madh: "Libri i Uratave" dhe "Libri i Petrarqués" (prezantimin e këtyre kodikëve e kemi bërë te monografia "F. Andrea, D. Muka, "Tre libra të bibliotekës kastriotase në përfaqje me heraldikën shqiptare", Studia Albanica, 2007" foto 4, 5, 6).

Më tej, sikurse pohon me të drejtë edhe prof. L. Alia në studimin "Skënderbeu në Artet figurative të shek. XV", mbetet po ashtu e hapur çështja se gjatë shek. XV duhet të ketë pasur edhe vepra të tjera me portretin origjinal të Skënderbeut. Një portret i tillë i Skënderbeut është kataloguar për shembull nga "The Athenaeum



– a journal of literature, NR3066, 31 July 1886, f. 130", ku vihet dukje: "Portret i Skënderbeut nga Alesso Baldovinetti" (1425-1499), bashkëkohës ky i G. Bellini-t dhe A. Pisano-s. Album-Antologjia jonë "Skënderbeu – Heroi Kombëtar i Shqiptarëve, 1413-2017", konkretisht "Pjesa shtojcë – Katalogu" dëshmon për mjaft vepra në këtë

drejtim, "të inventarizuara në kartë", të themi, por të humbura apo ende të pazbuluara.


Duke u shkëputur nga medaljonet e para me portretin e Skënderbeut, realizuar gjatë kohës kur vetë Heroi ishte gjallë (a nuk na kanë ardhur historikisht që nga Lashtësia portretet më të hershme

të mbretërve dhe të figurave të shquara fillimisht nëpërmjet monedhave e medaljoneve?!), le ta themi pa drojë se sot kemi – gjithnjë duke iu referuar viteve 1460 dhe për aq sa na lejon njohja e derisotme – edhe portretin më të parë, më të hershëm e më origjinal të Skënderbeut, fatmirësisht me ngjyra, ndonëse në miniaturë (foto. 7). Është fjala për portretin e Skënderbeut në kodikun "De Romanorum Magistratibus" të Andrea Domenico Fiocco-s, Romë 1465, që ndodhet sot në Bibliotekën e Universitetit të Harvardit, Houghton Library, Cambridge Mass. me numër rendor MS Typ 496. Studimin më të plotë për këtë portret, më të argumentuar shkencërisht, me të dhëna të sakta dhe referime të shumta ia ka bërë të njohur kohët e fundit publikut shqiptar studiuesi pasionant Ilia S. Karaxha, i cili ka hedhur tanimë teza të guximshme për historiografinë shqiptare të periudhës skënderbejeane. Me të drejtë, Karaxha nënvizon në studimin e tij "Skënderbeu autentik dhe modeli i Romës antike" ("Zemra shqiptare", nëntor 2014), lidhjen organike të këtij portreti të Heroit jo vetëm me portretet e tij në medaljone, por edhe me portretin e Skënderbeut te Barleti, e më tej me portretin mbi portën kryesore të Pallatit të Skënderbeut në Romë (foto 8).


Sinjalin e parë të pranisë së këtij portreti e dha prof. Shaban Sinani kur e botoi atë me cilësi shumë të dobët (fotokopje) në veprën e tij "Beratinus" (Argeta LMG, Tiranë, 2004). Më 2005, Prof. Kaliopi Naska botoi në "Revista Ushtrake" shkrimin "Si u gjet thesari i Drishtit?", ku vinte në dukje për herë të parë praninë e kodikut "De Romanorum Magistratibus" si dhe dy ilustrimet e këtij kodiku, njëri prej të cilëve, siç theksonte ajo me të drejtë, "... portreti më i hershëm i njohur gjer më sot i Gjergj Kastriotit". Më pas, në maj 2007, antikuari Dritan Muka në Kanada më dërgoi me e-mail historikon e shitjes së këtij kodiku si dhe përshkrimin e tij të hollësishëm sipas katalogut "Rare books and early mss, bot. Davies & Orioli, London, 1962" (foto 9). Por u desh, disa vite më pas, pena e studiuesit Karaxha për të dhënë të plotë tablonë sinoptike të portretit origjinal të Heroit tonë kombëtar, si dhe përfaqesin e tij me krejt portretet më të hershme të Skënderbeut që njihen deri më sot.

Mund të shtrojmë me të drejtë pyetjen: po përse ky portret origjinal i Skënderbeut në këtë kodik të titulluar "De Romanorum Magistratibus, Roma, 1465", që shqip do ta përkthenim "Magjistërit romakë" apo më thjesht "E drejta Romake"? Në çfarë rrethanash duhet të jetë realizuar, dhe përse?

Të dhënat flasin se humanisti dhe jurist-konsulli italian Andrea Domenico Fiocco (1477-1452 – që mbante në atë kohë si pseudonim edhe emrin e historianit romak Lucio Feneftella, të kohës së Tiberit) duhet ta ketë shkruar veprën e tij të famshme "De Romanorum Magistratibus" rreth vitit 1427, koha kur ai ishte kanonik i Firencës. Kjo vepër e shkëlqyer e Rilindjes italiane ishte një risi, stoli, thesar, që u kopjua me dorë nga skribë të njohur shumë herë dhe shumë më përpara shpikjes së Gutenbergut, vepër që do vazhonte të kopjohej si kodik, i pjesshëm a i plotë, deri në vitet 1490.



STUDIME | KËRKIME



Medaljonet e para që i njihen Pisanello-s, a janë të viteve 1449-1451

vijon nga faqja 19

Fakti që ekzemplari "De Romanorum Magistratibus" i vitit 1465 përmban dy ilustrime mjaft domethënëse me tematikë arbërore (çelet me miniaturën e një prifti dominikan që i dhuron – e nënvizojmë këtë fjalë për të mos thënë i dorëzon – kodikun një princi shqiptar (foto 10), dhe mbyllet me më të famshmin e më të parin portret të Skënderbeut) vetë ky fakt na jep neve sot të drejtën të parashtrijmë tezën tonë se vepra e Fiocco-s duhet t'i jetë bërë dhuratë drejtpërdrejt Skënderbeut në emër të Vatikanit gjatë vizitës së tij po atë vit në Romë. E mbështesim nga ana tjetër këtë tezë tonën edhe me faktin se tashmë tre kodikë të tjerë me emblemë kastriotase i ishin bërë dhuratë Skënderbeut (në vitet 1450-1465) qoftë nga Alfonsi e Ferdinandi i Aragonës, qoftë nga Vatikani, dhe konkretisht "Libri i Uratave", "Libri i Petrarkës" dhe "Libri i Skënderbeut", ky i fundit një lloj enciklopedie e kohës. Pra, për mendimin tonë, "De Romanorum Magistratibus - 1465" i Fiocco-s, me portretin original të Skënderbeut ka qenë kështu kodiku i katërt i "Bibliotekës Kastriotase", në pronësi të drejtpërdrejtë të Familjes Kastrioti në Krujë për aq kohë sa ishte gjallë vetë Heroi Kombëtar. Më pas, këto libra të çmuar për kohën dhe për personin që i zotëronte, kreyt kancelaria kastriotase, objektet më me vlerë të Heroit, nga shpatat (dhe jo një, por shumë!), deri te përkrenarja, u morën dhe u mbartën të gjitha në Itali me anije të posaçme (ndoshta dhe vetë trupi i Heroit?) nga Donika Kastrioti për t'i mbrojtur nga rrënimi osman e për t'i pasur pranë vetes si thesare dhe si trashëgimi për të birin dhe pasuesit e tij, e mbi të gjitha si dëshmi historike të çmuara për Bëmat e Krye-Heroit shqiptar. A nuk ndodhi kështu edhe me "Zojën e Këshillit të Mirë", ikonën shpirtërore dhe partonen e gjithë Arbërisë dhe të arbërve?

Në fakt, nuk është se kundërshtojmë këtu tezën e Karanxhës, sipas së cilës "De Romanorum Magistratibus - 1465", me portretin e Skënderbeut, duhet të ketë qenë në pronësi të Raffaele Maffei Voterano-s dhe që këtë kreyt arsyetimi i tij i drejtë për lidhjen

organike të portretit të Skënderbeut me grafikën e veprës së Barleti – Beçikemit "De Vita et Gestis Scanderbegi" (foto 11). E pranojmë tezën e tij deri në këtë pikë, por jo më tej. Nuk besojmë, me një fjalë, që ky kodik të ketë qenë më herët (pas vitit 1465) në pronësi të Gherardo di Maffei-t (i ati i Raffaele-s), në nderim të fisnikërisë së tij. Madje, vetë Karanxha e vë në pikëpyetje këtë tezë duke pohuar konkretisht: "Hulumtimin në këtë pikë mund ta konsiderojmë akoma të hapur" (!) Sigurisht, në këtë mes, siç pohon edhe ai, kanë dorë – për gjithë sa rrodhi më pas në Itali me objektet e Heroit –, Pjetër Engjëlli e Ferrante Kastrioti që jetonin dhe vepronin mes parisë dhe fisnikërisë së Napolit.

Nga ana tjetër, dëshmia e André

për faktin që portretet e Skënderbeut kishin filluar të përhapeshin në masë përtej Italisë, për mbajtjen gjallë të kujtimit të Heroit, sidomos në mbarë trevat arbërore. E dëshmon po ashtu edhe portreti i Skënderbeut (ndoshta nga Bellini) që ka qenë ruajtur historikisht nga familja Curani në Shkodër (foto 13), si dhe ish koleksioni i famshëm i kardinal Albanit në Romë, që mbante mjaft portrete të Skënderbeut të shek. XVI me autorë anonimë (foto 14, 15, 16), dhe sidomos portrete po të Skënderbeut të stilit tashmë "të fantazuar" (foto 17, 18, 19) me autorësi emrash të mëdhenj të Rilindjes Europiane, që nga Antonio Pallaiulo e Giorgione, deri te Guercino, Ticiani, Rembrandt, të cilët do pasoheshin gjatë Rilindjes shqiptare

e portreteve të Skënderbeut në kreyt Europën. Po ashtu, portreti i njohur i Skënderbeut nga Christofano dell'Altissimo në Muzeun Uffizi (mbi bazën e originalit të Bellini-t), do shndërrohej që herët mes shqiptarëve, brenda dhe jashtë vendit, si portreti më shpirtëror e popullor i Heroit Legjendar (foto 21), duke u vënë sidomos në qendër të Rilindjes shqiptare, të studimeve, publikimeve dhe arteve grafike. Kjo edhe për faktin se ky portret përmban, sikurse theksojnë M. Zeqo, L. Alia dhe mjaft studiues, vragën (plagën) në tëmth të Skënderbeut marrë në betejë rreth moshës 60 vjeçare, në bazë të dëshmisë historike të Barletit.

Sigurisht tonin në shtimin e portreteve të Skënderbeut, më të her-


gjermanë, zviceranë e flamandë, nga Jorg Breu, Ati dhe i Biri, te Hans Schaufelein, Jost Amann, Tobias Stimmer, Domenicus Custos, pasuar nga J. Pontanus, De Bry, P.C. Balthasar, etj. (foto 23, 24, 25).

Shekujt XVI-XVII dëshmuar për një vlerë e famë gjithnjë në rritje të Kastriotit të Madh, duke e shndërruar Krye-Trimin shqiptar në simbol qëndrese të paepur përpara superfuqisë së kohës që përfaqësonte Perandoria osmane, përpara rezikut të saj iminent kërcënues, ku ndodhej Italia dhe mbarë Europa. Krahas përkthimit në shumë gjuhë europiane të Barletit mbi bazën e "Historisë së Skënderbeut" të frëngut Jacques de Lavardin (foto 26), krahas shtimit të monografive për Heroin shqiptar, kërkohej tan-

imë, dhe u arrit me sukses, dhe për një kohë të gjatë e në vazhdim, që Heroi shqiptar të paraqitej Epokal, Burrë shteti i madh, Luftëtar i paepur, Mbrojtës i Krishtërit, siç kishte qenë në të gjallë të tij me vetë titullin "Atlet i Krishtit" që mbajti gjer në fund me nderin e Shqiptarit të Madh e të Krye-Heroit,

me nderin e "Babait të Kombit", siç e ka quajtur Faik Konica.

Botohet sipas revistës "Koleksionisti", organ i Shoqatës së Koleksionistëve të Shqipërisë me rastin e 613 vjetorit të lindjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut, 6 maj 1405.



Thevet, kozmografi i mbretit të Francës, që ka vizituar Ballkanin në mesin e shek. XVI dhe ka gjetur portret original të Skënderbeut mes shqiptarëve në Butola (apo Bitola, emri i hershëm i Manastirit) të Arbërisë (foto 12), është domethënëse

nga Theohar Gjini për një portret psikologjik të Skënderbeut (fig 20). Vetë shpërbërja e koleksionit të kardinal Albanit pas vdekjes së tij, me shitjet private që u bënë, do të ishte një shtysë e re e mëtejshme për përhapjen dhe shumëfishimin

shme dhe më pranë origjinaleve të Bellini-t dhe shokëve të tij e dhanë që pas vdekjes së Heroit piktorët e shqar italianë të shek. XVI, sidomos Bernardino Vitalibus (foto 22), të cilët shpejt do pasoheshin nga ilustratorët francezë e sidomos ata


INSTITUCIONET KULTURORE

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Instituti i Statistikave ka bërë publike rezultatet e tremujorit të parë të vitit 2018 për frekuentimin e institucioneve kulturore. Sipas Institutit të Statistikave rezultojnë se “në Bibliotekën Kombëtare ka gjithmonë e më pak lexues. Të dhënat e fundit të Institutit të Statistikave tregojnë se gjatë tremujorit të parë të këtij viti, numri i shërbimeve të njësive bibliotekare dhe numri i frekuentuesve të Bibliotekës Kombëtare ka pësuar një rënie të ndjeshme me rreth 86.0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.” Gjithashtu, “Në bibliotekë ka pasur gjithashtu, më pak tituj librash, një element ky që ndikon në uljen e atraktivitetit të saj. “Në tremujorin e parë 2018, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 1.812 botime, 62.8 % më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 340 ishin tituj të rinj dhe 1.472 ekzemplarë të rinj”, theksohet në raportin e INSTAT për Statistikat e Kulturës.

Por një rënie të të pazakontë ka edhe numri i vizitorëve në këto tre muaj në Galerinë Kombëtare të Arteve, të cilën INSTAT e ka llogaritur me minus -100%, pra zero vizitorë.

Edhe pse kanë kaluar tre muaj nga marrja e detyrës, drejtuesi aktual i kësaj Galerie, Erzen Shkololli, nuk jep asnjë shpjegim për kalendarin e ri të institucionit, por shprehet se “Se do t’ju thërras kur të jem gati në një konferencë për mediat”. Salla e madhe e ekspozitave në këtë institucion prej tre muajsh qëndron me muret bosh. Ndryshe është numri i vizitorëve nëpër muzetë, ku sipas INSTAT “Numri i vizitorëve në muze në tremujorin e parë 2018 është 24.477, duke shënuar rritje me 83,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.



INSTAT: Shqiptarët “braktisin” Bibliotekën Kombëtare e GKA

86% lexues më pak, Galeria Kombëtare e Arteve zero vizitorë... Teatrot, rritje të spektatorëve, Eksperimentalit ka shënuar rritje prej 197,2 %

Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 39,4 %, ndërmjet tremujorit të parë 2018 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2017. Në tremujorin e parë 2018 numri

i vizitorëve në parqe arkeologjike është 13.872, me një rritje prej 61,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.”

Ndërkaq ajo që bie në sy

me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.”

FREKUENTIMI DHE BOTIMET NË BIBLIOTEKËN KOMBËTAR

Treguesit	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.1 2017-Tr.1 2018)
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	38	22.524	24.798	24.941	5.098	-86,7
Frekuentimi	36	26.294	29.552	32.150	4.987	-86,0
Numri i botimeve	5	3.322	2.851	5.464	1.812	-62,8
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	927	661	609	1.046	340	-63,3
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	4	2.661	2.242	4.418	1.472	-62,7

VIZITORE NË MUZE, PARQE ARKEOLOGJIKE DHE KALA

Numri i vizitorëve	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.1 2017-Tr.1 2018)
Muze	13,327	56,375	78,479	52,805	24,477	84
Kala e Monumente të tjera	12,962	58,059	102,621	27,506	18,075	39
Parqe Arkeologjike	8,606	71,773	150,859	29,650	13,872	61
Numri i vizitorëve gjithsej	34,895	186,207	331,959	109,961	56,424	62

është numri i frekuentuesve të shfaqjeve kulturore në teatrot kryesore të Tiranës. Sipas INSTAT, “Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e parë 2018 është 218 spektatorë/vizitorë për shfaqje, dhe ka pësuar rritje me 7,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Në tre muajt e parë të 2018-s numri i shfaqjeve kulturore ka qenë 344, duke pësuar një rritje vjetore me 61.5 %. Në rritje është edhe numri i spektatorëve. Në tremujorin e parë të këtij viti arriti në 74.848 spektatorë, duke pësuar rritje me 73.4 % kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017.”

Një rritje të ndjeshme të vizitorëve në shfaqje ka pasur Teatri Eksperimental “Kujtim Spahivogli”. INSTAT konstaton se “Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, 207 shfaqje/ekspozita në tremujorin e parë 2018. Numri i spektatorëve në tremujorin e parë 2018, është 40.555, duke shënuar rritje prej 197,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Numri mesatar i spektatorëve gjatë tremujorit të parë 2018 është 196 spektatorë/vizitorë për shfaqje me një rritje prej 46,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.” Ndërkohë statistika tregojnë se

Numri i shfaqjeve kulturore të realizuara nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në tremujorin e parë 2018 është 51 shfaqje/ekspozita, duke shënuar rënie me 3,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Në tremujorin e parë 2018, numri i spektatorëve është 6.339 duke shënuar rënie me 19,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Numri mesatar i spektatorëve në tremujorin e parë 2018 është 124 spektatorë/vizitorë për shfaqje duke pësuar rënie me 16,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

COLOURS OF ALBANIA 2018

Në fokus trashëgimia kulturore e përkatësia evropiane e Shqipërisë

Konkursi Colours of Albania 2018 ka çelur siparin në mjediset e Universitetit të Arteve nën moton “Trashëgimia kulturore dhe përkatësia evropiane”. Konkursin e ka përshëndetur edhe vetë kryeministri Edi Rama në orët e para të mëngjesit, duke postuar në statusin e tij në Facebook fotografinë e preferuar:

MIRËMËNGJES

dhe me lajmin e çeljes së konkursit të fotografisë dixhitale #Colours of Albania 2018, që për këtë vit do të fokusohet tek “Trashëgimia kulturore dhe përkatësia evropiane” e Shqipërisë, ju uroj një fundjavë

të qetë Konkursi do të jetë i hapur deri më 30 korrik 2018 për të gjitha fotot tuaja që do të nxjerrin në pah vlerat e jashtëzakonshme të shoqërisë shqiptare apo pamjet mahnitëse që aparati juaj mund të kapë lehtësisht në çdo pëllëmbë të vendit.”, shkruan Kryeministri Rama.

Konkursi u çel në prani të Ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati, Ministres së Kulturës, Mirela Kumbaro, Ambasadores së Delegacionit të BE-së në Shqipëri Romana Vlahutin, trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri dhe shumë të ftuarve të tjerë nga fusha

e artit dhe kulturës. Konkursi do të përfshijë edhe temat mbi ngjyrat e shoqërisë shqiptare, bashkëjetesën fetare, qytetet e fshatrat mahnitëse, bregdetet e peizazhet e paprekura, si dhe transformimin e Shqipërisë në vitet e fundit dhe rilindjen e zonave rurale. Ambasadorja e Delegacionit të BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin, e cila hapi këtë edicion u shpreh se “jam e lumtur që në këtë libër që është një nga më të preferuarit e mi, ju nuk shihni vetëm vende të bukura, por edhe njerëz të bukur dhe ky është një pasqyrim i ngjyrave, shpirtit dhe zemrës së Shqipërisë”.



Teuta mund Partizanin, Flamurtari barazon në fund me Vllazninë

Java 32-të është mbyllur me surpriza e akuza për rezultate e vendime të dyshimta. Laçi përmbys Skënderbeun, tifozët e irrituar

Rezultate surprizë ka sjellë java e 32-të e Kategorisë Superiore. Partizani ka humbur me lehtësi në Tiranë nga Teuta 1-3, ndërsa Skënderbeu pasi arriti të krysonte 2-0 u mund 3-2 nga Laçi. Tifozët e të dyja skuadave kanë akuzuar drejtuesit e lojtarët për lënie të qëllimshme të ndeshjeve. Po kështu të irrituar dhe me akuza ndaj ekipit kanë qenë edhe tifozët e Kamzës pas barazimit 0-0 me Luftëtarin. Nga ana tjetër në Vlorë, ku Flamurtari ka barazuar në shtesë 1-1 me Vllazninë ka apsur një konflikt me vlonjatëve dhe arbitrave. Të dyja palët kanë denoncuar njeri-tjetrin në polici. Vlonjatët nëpërmjet administratorit Sinan Idrizi kanë denoncuar në polici arbitrat sepse sipas tyre kanë lëshuar ofendime drejt tifozërisë vendase, ndërsa gjyqtarët kanë bërë denoncim në drejtim të klubit Flamurtari për ofendim dhe dhunë.

PARTIZANI - TEUTA 1-3

Teuta përmbys Partizanin dhe merr një fitore me shumë vlerë për mbijetesën. Edhe pse "demat" ishin në avantazh, nuk mundën që të menaxhonin rezultatin, pavarësisht se Batha u tregua i saktë nga pika e bardhë e penalltisë në 16'. Ishte Çyrbja që fillimisht shënoi golin e barazimit për miqtë para fundit të pjesës së parë. Në fraksionin e dytë shënuan dhe Hrkaç e Hila për t'i dhënë fitoren "djemve të detit" që tashmë shkojnë 2 pikë pas Kamzës dhe barazohen me pikë me Vllazninë. Në anën tjetër kryeqytetasit i ndërlikojnë pozitën e tyre për zonën europiane, pasi e shohin Luftëtarin e vendit të tretë 5 pikë larg dhe ndodhen në vendin e pestë, sepse i ka parakaluar dhe Laçi e tashmë rrezikojnë jo pak. Pas përfundimit të ndeshjes tifozët e Partizanit kanë reaguar të revoltuar nëpër rrjetet sociale duke e cilësuar ndeshjen si të lënë qëllimisht për të favorizuar Teutën që i duhen pikët për mbijetesë në kategori.

FLAMURTARI - VLLAZNIA 1-1

Flamurtari e Vllaznia janë



Partizani - Teuta

ndarë në barazim 1-1 në Vlorë, në një ndeshje dramatike, me emocione, gola dhe nerva pa fund, për shkak të rëndësisë së takimit. Flamurtari kërkonte pikë për të shpresuar tek Europa, por ishte shumë pranë

humbjes. Vllaznia goditi në kundërsulm me Ribajn pak minuta para fundit, në 84', duke respektuar në maksimum planin e trajnerit Gjoka, por në minutat shtesë Flamurtari gjeti barazimin me Seku



Kamza - Luftëtari

Kamara. Ndonëse erdhi në fundin e shtesës, barazimi i Flamurtarit ishte i merituar dhe minimumi, pasi goditi dy herë shtyllën më parë gjatë ndeshjes. Ndërsa Vllaznia ka humbur një penalti, e priti

portieri Nurkoviç.

LAÇI - SKËNDERBEU 3-2

Skënderbeu ka kaluar në avantazh të dy golave në Laç, kur Soëe shënoi 2 gola në 31' dhe 39'. U duk sikur

gjithçka u vendos, por Lulaj në sekondat e para shtesë të fraksionit të parë kthen në lojë Laçin. Kurbinasit besojnë shumë dhe në minutën e 53-të Reginaldo barazon shifrat. Nëntë minuta më pas është sërish Reginaldo që shënon dhe përmbys Skënderbeun në 3-2. Në përfundim të ndeshjes trajneri Ilir Daja është shprehur i zhgënjyer nga paraqitja e skuadrës duke aluduar se edhe mund të largohet nga drejtimi. "Do të rishikoj pozicionin tim", ka deklaruar Daja. Po kështu në rrjetet sociale shumë prej tifozëve korçarë kanë shfaqur indignitetin e tyre për këtë rezultat, i cili sipas tyre ishte një lënie e hapur e ndeshjes për Laçin.

KUKËSI - LUSHNJA 2-1

Në Kukës, vendasit kanë vuajtur jo pak për të fituar 2-1 përballë Lushnjës së vendit të fundit dhe të rënë tashmë nga Superiorja. Guri ka shënuar golin e parë në minutën e 33-të. I 17-i gol për sulmuesin e Kukësit. Lushnja vendos ekuilibrin teksa në një prej daljeve përpara, Pepa ndalet në mënyrë të parregullt nga Hoxha dhe përfiton një 11-metërs. Pepa tregohet i saktë dhe i çon skuadrat në dhomat e zhveshjes në barazim. Në fraksionin e dytë Kukësi do ishte më agresiv, por do duhej një lëvizje e Peter Pacult që skuadra të merrte avantazhin. Austriaku aktivizoi pas shumë ndeshjesh sulmuesin Balde dhe ky i fundit shënoi pak sekonda më vonë, duke vendosur fatin e takimit pas një harkimi të Zhderiç. Miqtë e mbyllën ndeshjen me 10 lojtarë pasi Pepa u ndëshkua me karton të kuq pas një përplasje me Zhderiç.

KAMZA - LUFTËTARI

Kamza është ndalur te barazimi pa gola në fushën e vet nga Luftëtari. Themi "ndalur" për faktin se ishin kamzalinjtë ata që mbajtën frenat e lojës. Ata humbën një 11-metërs në minutën e 76-të, vendim i dyshimtë i arbitrit Jorgji, sepse nga pamjet filmike duket se Raçiç simuloi. Gjithsesi, drejtësinë e vendosi në vend portieri grek Athanasopoulos, duke grushtuar dhe duke mbajtur rezultatin të bardhë.

FLAMURTARI-VLLAZNIA

Arbitrat dhe vlonjatët denoncojnë njeri-tjetrin në polici

Ndeshja e djeshme Flamurtari-Vllaznia e cila mbaroi në barazim mes dy skuadrave është shoqëruar me tension dhe të shara mes tifozërisë vlonjate dhe gjyqtarëve të ndeshjes. Gjyqtarët janë larguar me furgon policie vetëm 1 orë e 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes. Shkak i tensionimit të situatës ka qenë momenti kur ka përfunduar ndeshja dhe arbitrat kanë lëshuar ofendime drejt tifozërisë vendase, e cila gjatë ndeshjes

ka ofenduar dhe sharë katërshen e gjyqtarëve. Tension ka pasur edhe jashtë stadiumit dhe është dashur mbi një orë që policia të qetësojë situatën dhe të nxjerrë jashtë ambienteve të stadiumit arbitrat e ndeshjes. Administratori i Flamurtarit, Sinan Idrizi ka bërë denoncimin në polici për gjyqtarët, ndërsa i ka quajtur persona që luajnë me ndjenjat e një qyteti. Gjithashtu edhe gjyqtarët kanë bërë denoncim në drejtim të klubit Flamurtari.



REPORT TV

ISH-TRAJNERI

Alex Ferguson Pëson hemorragji cerebrale, në gjendje të rëndë

Ish trajneri i Manchester United Alex Ferguson është shtruar në spital me emergjencë pas probleme me shëndetin. Pas mbërritjes në spital mjekët kontaktuan se Ferguson kishte pësuar një hemorragji cerebrale. Ferguson u operua menjëherë për shkak të gjendjes së tij të rënduar. Operacioni ka shkruar shumë mirë, raportojnë mjekët. Ekipi i Manchester United sqaron

se Ferguson do të jetë në një periudhë të kujdesit intensiv, për të cilën ka nevojë për t'u shëruar. Ndërkohë, familja e Ferguson kza kërkuar privatësi për këtë çështje. Alex Ferguson ishte i pranishëm 1 javë më parë kur Manchester United luajti kundër Arsenalit, ku ai përgatiti një dhuratë për Wenger në shenjë mirënjohje pasi francezi do të largohet pas 22 vitesh nga 'topçinjtë'.



TROFEU

Flamurtari shpallet kampion në basketbollin e femrave

Tri finale nga pesë të tilla i janë dashur Flamurtarit në basketboll për femra të shpallej sot pasdite kampion i Shqipërisë. Vajzat vlonjate fituan dje 76-65 ndaj Tiranës në finalen e tretë të play off-it, duke fituar 3-0 serinë e finaleve. Një triumf i merituar i ekipit vlonjat, që para publikut të tij sot nuk zhgënjëu, duke e komanduar ndeshjen në shumicën e kohës. Për

Flamurtarin ky është titulli i 22-të në karrierë, por është trofeu i parë sezonal për vlonjatet, ndërkohë që Tirana ka fituar Kupën e Shqipërisë dhe Superkupën. Flamurtari arriti ta dominojë kampionatin në fazën e dytë, kur mori kreun e renditjes dhe e mbrojti atë deri në fund, ndërkohë që lojtarat e mira i tregoi edhe në play off. Fitorja 3 ditë më parë në finalen e dytë në Tiranë ishte shumë e



rëndësishme për rrugën drejt titullit, pasi suksesi arritur në fushën e bardhebluve praktikisht vulosi suksesin e titullit.

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!



BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War



BUNK'ART 2


- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 1?
Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 16:00 të hënë & të martë pushim



Ku ndodhet BUNK'ART 2?
Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 18:00 çdo ditë

www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime / Reservations: +355 (0) 67 20 72 905

